

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5594  
E premte, 5 tetor 2018  
çmimi 0.40 €

## BE-ja dhe OSBE-ja kërkojnë transparencë nga partitë politike

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### A PO LINDË SERBIA E PUTINIT? F. 11

Milazim KRASNIQI

#### KAMPI USHTARAK I BUNDESWEHRIT NË PRIZREN KTHEHET NË PARK INOVATIV TRAJNUES BIZNESI F. 2

#### THAÇI PËRSËRIT: NUK KA PASUR MË SHUMË SE 15 MIJË LUFTËTARË ME ARMË DHE UNIFORMË F. 5

### EKONOMI

#### BB-ja: RITJA EKONOMIKE NË KOSOVË PRITET TË STABILIZOHET NË 4.2 PËR QIND F. 9

#### HAMZA VLERËSON MBËSHTETJEN E GJERMANISË PËR KOSOVËN F. 9

### KULTURË

#### PANAIRI VJESHTOR I LIBRIT AAB 2018, CILËSOHET MË I MIRI NË RAJON F. 6



### SPORT

#### ZOLLNERI LARGOHET NGA KB PRISHTINA, VJEN MULAOMEROVIQI F. 15

#### 'EPOKA E RE' SONTE PËRBALLET ME 'ZËRIN' F. 15

FLET PËR "EPOKËN E RE", LISEN BASHKURTI F. 4-5

## Faza e re e dialogut, e komplikuar dhe shumë e vështirë

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, ka thënë se procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë ka hyrë në një fazë të re, e cila synon të krijojë një marrëveshje që do t'i hapte rrugë gradualisht normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve. Ai ka thënë se kjo fazë duket të jetë e gjatë, e komplikuar dhe shumë e vështirë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bashkurti ka theksuar se propozimi për korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi është ideja më e komplikuar teorikisht dhe më e vështira për t'u realizuar praktikisht. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës duhet ta bëjnë punën e tyre në procesin e dialogut duke demonstruar legjitimitet, transparencë, përgjegjshmëri, gjithëpërfshirje dhe, tek pastaj, të kërkojnë partnerë ndërkombëtarë mbështetës si ShBA-ja, BE-ja apo shtetet individuale



KONFERENCA RAJONALE KUNDËR KORRUPSIONIT KA FILLUAR  
PUNIMET NË PRISHTINË

## Ndërkombëtarët bëjnë thirrje të luftohet korrupsioni

### REGIONAL ANTI-CORRUPTION CONFERENCE



Në Konferencën Rajonale Kundër Korrupsionit, e cila po mbahet në Prishtinë, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë të enjten se strategjia e zgjerimit të BE-së në lidhje me Ballkanin është e qartë dhe kërkon që këto vende duhet të shkëputen nga lidhjet me

krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës. Ndërkaq ambasadori i Britanisë në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka theksuar se Britania është mjaft e shqetësuar për kërcënimet ndaj prokurorëve që ndodhën në ditët e fundit në Kosovë F. 3



#### Ministri Shala: Do t'i mbroj prodhuesit nga importi i pabarabartë

FAQE 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Magëdoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Vuçiqi heq gjendjen e "gatishmërisë së lartë ushtarake"

BEOGRAD, 4 TETOR - Ministria e Mbrojtjes e Serbisë tha se ka marrë urdhër nga presidenti Aleksandër Vuçiq për heqjen e "shkallës së lartë të gatishmërisë" për Ushtrinë serbe. Të shtunën mbërma presidenti serb tha se ka vënë ushtrinë në gjendjen më të

lartë të gatishmërisë dhe "Serbia nuk do të lejojë dhunë mbi serbët në Kosovë". Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, shkoi të shtunën në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe, në një vizitë të paparalajmëruar. Ai qëndroi edhe në

liqenin e Ujmanit, që është edhe një nga pikat e nxehta të bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një pjesë e liqenit artificial që është ndërtuar në vitet '80 shtrihet në Serbi dhe ka rëndësi për furnizimin me ujë të termocentraleve të

Kosovës dhe në muajt e verës edhe të disa komunave të Kosovës, përfshirë edhe kryeqytetin. Në një deklaratë pas vizitës presidenti Thaçi tha se "ishte një vizitë e zakonshme fundjave", ndërsa ritheksoi se "Kosova është një, e



pandashme, e pavarur dhe shumetnike".

# Kampi ushtarak i Bundeswehrit në Prizren kthehet në park inovativ trajnues biznesi

Prania ushtarake gjermane dhe kampi ushtarak gjerman në Prizren kalon në prani ekonomike, pasi kampi ushtarak i Bundeswehrit në Prizren kthehet dhe fillon si procedurë në një Park Inovativ Trajnues Biznesi. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se investimi gjerman në vendin tonë është i çmueshëm dhe ne po krijojmë më shumë hapësirë për investitorët nga Gjermania

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka marrë pjesë të enjten në ceremoninë lamtumirëse, të tërheqjes së ushtarëve gjermanë, nën tingujt e Orkestrës Ushtarake të Forcave Alpiniste të Bundeswehrit, nga kampi në Prizren, ku kaluan gati dy dekada në shërbim të paqes. Nga dita e enjte prania ushtarake gjermane dhe kampi ushtarak gjerman në Prizren kalon në prani ekonomike, pasi kampi ushtarak i Bundeswehrit në Prizren kthehet dhe fillon si procedurë në një Park Inovativ Trajnues Biznesi. Prania ushtarake gjermane do të ven-

doset në Prishtinë, për të shërbyer edhe më tutje në sigurinë e qytetarëve të Kosovës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se ushtarët gjermanë i kontribuuan stabilitetit të Kosovës, duke krijuar një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët. "Krenarë që bashkë ia dolëm ta kapërcejmë konfliktin dhe të shohim drejt së ardhmes në paqe e harmoni. Flamuri gjerman do të mbetet i ngritur lart në Kosovë falë shërbimit të tyre të dinjitetshëm dhe profesional, tash në Parkun Inovativ-Trajnues e të Biznesit. Investimi gjerman në vendin tonë



është i çmueshëm dhe ne po krijojmë më shumë hapësirë për investitorët nga Gjermania", ka thënë Haradinaj. Kryeministri Haradinaj të enjten ka pritur në takim edhe një delegacion të lartë nga Qeveria gjermane, kryesuar nga Thomas Richard Silberhorn, sekretar Shteti

në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Maria Flachsbarth, sekretare Shteti në Ministrinë për Bashkëpunim Ekonomik, përfaqësues të Bundestagut dhe përfaqësues të Bundeswehrit, me të cilët ka biseduar për mundësinë e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në të gjitha fushat, me

theks në zhvillimin ekonomik. Pas takimit, kryeministri Haradinaj në një konferencë për media ka falënderuar përfaqësuesit e delegacionit të lartë gjerman për vizitën, duke theksuar se kjo është një dëshmi e bashkëpunimit dhe partneritetit të mirë që ka Kosova me shtetin gjerman. "Flamuri gjerman do të mbetet lart përgjithmonë në Kosovë, për shërbimin që e kanë bërë me nder, burra dhe gra të Gjermanisë në Kosovë në uniformën gjermane", ka thënë kryeministri Haradinaj, dhe ka veçuar faktin se gjermanët do të vazhdojnë të jenë të pranishëm në misionin e KFOR-it.

Ndërkaq Thomas Richard Silberhorn, sekretar Shteti në Ministrinë e Mbrojtjes, tha se ka ardhur koha t'i kalojmë përgjegjësitë të kosovarët dhe t'i dorëzojmë instrumentet tona ushtarake në instrumente civile dhe në rritjen ekonomike për generatat e ardhshme në Kosovë.

## Bashkimi i Gjermanisë festohet edhe në Kosovë



PRISHTINË, 4 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë marrë pjesë të enjten në pritjen e Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë për "Ditën e Gjermanisë". Presidenti Thaçi ka thënë se sot po e shënojmë së bashku përvjetorin e njëzet e tetë të bashkimit të Gjermanisë. "Bashkimi i Gjermanisë, në vitin 1990, u përcoll me ndryshime dramatike në gjithë Evropën. Atë ditë, përveçse

u bashkuan dy Gjermanitë, në të njëjtën kohë u hodhën themelet e një Evrope të bashkuar rreth vlerave më të qëndrueshme të qytetërimit perëndimor", u shpreh presidenti Thaçi. Pa këtë ndryshimin e madh në Evropë dhe në botë, sipas presidentit Thaçi, do të ishte e paimagjinueshme që Kosova të bëhej vend i lirë dhe shtet i pavarur. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Gjermania me shembullin e saj

rrezaton shpresë për të gjithë popujt e shtetet që aspirojnë demokracinë, sundimin e ligjit, prosperitetin e tregut të lirë dhe drejtësinë sociale. "Vendi ynë, Kosova, duke pasur mbështetjen e fuqishme të shtetit gjerman, ndihet më e sigurt në rrugëtimin e saj euroatlantik", ka thënë Veseli. Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se shteti dhe kombi gjerman vazhdojnë të jenë bosht i përkrahjes shumëdimensionale të Kosovës.

## Shqipëria vijon angazhimin në misionet paqeruajtëse

BRUKSEL, 4 TETOR - Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka, po merr pjesë në Samitin e Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s. Samiti i Mbrojtjes po mbahet në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel. Me këtë rast, ministria Xhaçka në fjalën e saj nënvizoi angazhimin e Qeverisë

shqiptare për buxhetin dedikuar mbrojtjes. "Deri në viti 2024 buxheti për mbrojtjen do të jetë 2% e GDP-së. Pak ditë më parë u certifikuan 1 000 efektive të këmbësorisë nën monitorimin e NATO-s. Shqipëria do ta vijojë angazhimin në misionet paqeruajtëse", tha ministria e Mbrojtjes,

Xhaçka. Gjatë këtij samiti ministria Xhaçka u takua me sekretarin amerikan të Mbrojtjes, Mattis dhe sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Stoltenberg. Mattis e Stoltenberg vlerësuan angazhimin e Shqipërisë në operacionet e NATO-s.



Konferenca Rajonale Kundër Korrupsionit ka filluar punimet në Prishtinë

# Ndërkombëtarët bëjnë thirrje të luftohet korrupsioni

Në Konferencën Rajonale Kundër Korrupsionit, e cila po mbahet në Prishtinë, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë të enjten se strategjia e zgjerimit të BE-së në lidhje me Ballkanin është e qartë dhe kërkon që këto vende duhet të shkëputen nga lidhjet me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës. Ndërkaq ambasadori i Britanisë në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka theksuar se Britania është mjaft e shqetësuar për kërcënimet ndaj prokurorëve që ndodhën në ditët e fundit në Kosovë



**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 4 TETOR** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se institucionet e Kosovës kanë shënuar progres në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Në Konferencën Rajonale Kundër Korrupsionit, e cila po mbahet në Prishtinë, ai ka deklaruar se kjo është arritur duke shtuar kapacitetet për luftimin e këtyre dukurive negative. "Janë nxjerr akte ligjore që parandalojnë dhe sanksionojnë veprat e korrupsionit. Janë hartuar dokumente të politikave. Janë krijuar mekanizma për këtë qëllim dhe janë bërë hapa konkretë për forcimin e sundimit të ligjit. Në mënyrë graduale është rritur numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Janë ngritur kapacitetet e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe është shtuar buxheti për institucionet e sundimit të ligjit", ka thënë ai. Si nevojë e kohës, sipas presidentit Thaçi, legjislacioni i fushës kundër korrupsionit në vazhdimësi plotësohet, me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit. "Republika e Kosovës në mënyrë të vazhdueshme ka shënuar progres në luftën ndaj dukurisë së korrupsionit dhe krimin të organizuar. Sigurisht se gjithnjë ekziston mundësia që të

bëhet edhe më shumë për forcimin e sundimit të ligjit dhe të punohet më me profesionalizëm. Ne e dimë se lufta ndaj krimin të organizuar dhe korrupsionit nuk është e lehtë, por jemi të vendosur të ecim përpara", ka deklaruar si, duke shtuar se të arriturat e Kosovës kundër korrupsionit janë evidente tashmë. Më tej, ai ka thënë se korrupsioni nuk është çështje specifike vetëm për Kosovën apo për vendet e rajonit, por është një sfidë në shkallë globale. Sipas Thaçit, përveç në zhvillimet politike dhe socio-ekonomike, këto dukuri negative shkaktajnë pasoja edhe në rrafshin e sigurisë. "Prania e korrupsionit është në të gjitha shtetet, qoftë ato të zhvilluara, në zhvillim, por edhe tek ato vende që janë të pazhvilluara. Niveli dhe format e paraqitjes së korrupsionit janë të ndryshme. Andaj, bashkëpunimi i shteteve në këtë fushë është i domosdoshëm për arritjen e rezultateve në luftën ndaj dukurisë së korrupsionit", ka thënë presidenti Thaçi. Kreu i shtetit ka theksuar se Republika e Kosovës është shteti më i ri në rajon dhe përgjatë dhjetë vjetëve shtet ka marrë një sërë veprimesh me qëllim të konsolidimit të sundimit të ligjit dhe në funksion të respektimit të rendit kushtetues. "Rendi kushtetues i Republikës së

Kosovës bazohet, ndër të tjera, në parimin e sundimit të ligjit. Shteti ligjor dhe qeverisja e fortë, e prirë për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, e ushqejnë rritjen ekonomike të një vendi dhe hapë perspektivë për të gjithë qytetarët. Në këtë drejtim, Republika e Kosovës ka miratuar legjislacionin përkatës për këtë fushë, duke krijuar edhe mekanizma institucionalë dhe ndër-institucionalë për këtë qëllim. Por, kemi edhe sfida që ndërlidhen me zbatimin e legjislacionit dhe funksionimin e këtyre mekanizmave", u shpreh presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se sfidat duhet t'i tejkalojmë me profesionalizëm dhe përkushtim, duke bashkëpunuar dhe shkëmbyer përvoja me vendet e rajonit dhe më gjerë. Presidenti Thaçi ka thënë se rekomandimet që do të dalin nga kjo konferencë do t'i përfshijë gjatë rishikimit funksional të Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit, i cili është një trup koordinues nën udhëheqjen e tij. Përfaqësuesja e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka deklaruar se strategjia e zgjerimit të BE-së në lidhje me Ballkanin është e qartë dhe kërkon që këto vende duhet të shkëputen nga lidhjet me krimin e organizuar dhe kor-

rupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës. Ajo ka kërkuar që zyrtarët e akuzuar për korrupsion të largohen nga institucionet. Në këtë drejtim, ajo ka bërë thirrje për miratimin e një sërë ligjesh, përfshirë edhe atë për largimin e zyrtarëve të akuzuar nga institucionet. "Me gjithë arritjet që Kosova ka pasur në aspektin legjislativ, prapë ka hapësirë në këtë fushë. Duhet të miratohen ligji mbi sinjalizimin, ligji mbi heqjen e zyrtarëve të akuzuar, ligji mbi agjencinë. Këshilli i Evropës po harton një vlerësim i cili përfundon këtë vit dhe besoj se institucionet do t'i marrin parasysh rekomandimet nga ky raport", ka thënë ajo. Apostolova ka thënë se është me rëndësi të ketë ligje me standard të lartë dhe të realizohen kontrole të brendshme. "Lufta kundër korrupsionit mbetet prioritet kyç për BE-në në rajon. BE-ja në raportin për vitin 2018 i ka rekomanduar Kosovës të ndër-marrë hapa të fortë kundër korrupsionit", ka deklaruar Apostolova. Ajo ka thënë se luftimi i korrupsionit ndërlidhet edhe me çështjen e liberalizimit të vizave. Kurse ambasadori i Britanisë në Kosovë, Ruairi O'Connell, është shprehur i shqetësuar se korrupsioni ka

prekur shumë vende dhe po financon krimin e organizuar dhe terrorizmin në botë. O'Connell ka deklaruar se pushtetarët me integritet të lartë mund t'i rezistojnë këtij fenomeni dhe të jenë shembull për gjeneratat e reja. "Bashkëpunimi rajonal për ta luftuar korrupsionin është i nevojshëm", është shprehur ai. O'Connelli ka theksuar se Britania është mjaft e shqetësuar për kërcënimet ndaj prokurorëve që ndodhën në ditët e fundit. Duke folur për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, ai ka thënë se Britania përkrah anëtarësimin e Kosovës në Interpol. "Si Britani e përkrahim anëtarësimin e Kosovës në Interpol", ka theksuar ambasadori britanik Ruairi O'Connell. Ndërsa ambasadori i Italisë, Piero Cristoforo Sardi, ka thënë se lufta kundër korrupsionit bie në kuadër të luftës më të gjerë kundër krimin të organizuar dhe është pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për ta përforcuar atë që është e nevojshme për ta zbatuar sundimin e ligjit. Në këtë konferencë po marrin pjesë drejtues të institucioneve relevante nga Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Italia, Kroacia, Mali i Zi, Moldavia dhe Turqia.

## FSK-ja përfundon me sukses ushtrimin fushor 'Saber Junction 2018' në Gjermani

**PRISHTINË, 4 TETOR (ER)** - Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) nga data 12 shtator deri më 1 tetor të këtij viti mori pjesë në ushtrimin fushor "Saber Junction 2018" të mbajtur në Hohenfels në Gjermani. Kontingjenti përbëhej nga 10 pjesëtarë të Policisë së Forcës dhe dy vlerësues, kontrollues. Kontingjenti i FSK-së, i përbërë nga Policia e FSK-së, i është bashkangjitur Kompanisë Pranë Shtabore të

Batalionit të 54-t të Xhenios (54 th BEB) në Grafenwohr, në fazën e planifikimit dhe përgatitjes për zhvillimin e operacionit përfundimtar, luftimit Forcë me Forcë, kurse vlerësuesit - kontrolluesit kanë vazhduar trajnimin në Akademinë për Vlerësues - Kontrollues. Kontingjenti i FSK-së së bashku me njësitë e tjera kanë kryer aktivitete në ndërtimin e pikës së grumbullimit për të ndaluarit e luftës: organizimi, funksionimi, trajtimi i tyre,

përcjellja e konvojëve, pikat e kontrollit, ofrimi i sigurisë fizike, perimetri i sigurisë, kontrollimi i personelit dhe evakuimi i civilëve nga fushëbeteja. Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë rreth 5 500 pjesëtarë dhe njësi të ndryshme. Kontingjenti i FSK-së është vlerësuar për motivin e lartë, disiplinën dhe gatishmërinë e treguar gjatë gjithë kohës së realizimit të ushtrimin fushor "Saber Junction 2018".



Flet për "Epokën e re", Lisen Bashkurti

# Faza e re e dialogut, e komp



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, ka thënë se procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë ka hyrë në një fazë të re, e cila synon të krijojë një marrëveshje që do t'i hapte rrugë gradualisht normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve. Ai ka thënë se kjo fazë duket të jetë e gjatë, e komplikuar dhe shumë e vështirë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bashkurti ka theksuar se propozimi për korigjimin e kufirit Kosovë - Serbi është ideja më e komplikuar teorikisht dhe më e vështira për t'u realizuar praktikisht. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës duhet ta bëjnë punën e tyre në procesin e dialogut duke demonstruar legjitimitet, transparencë, përgjegjshmëri, gjithëpërfshirje dhe, tek pastaj, të kërkohen partnerë ndërkombëtarë mbështetës si ShBA-ja, BE-ja apo shtetet individuale

**EPOKA E RE** **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 4 TETOR -

**"Epoka e re":** Z. Bashkurti, Kosova dhe Serbia janë në fazën e fundit të dialogut. Si e shihni këtë proces?

**Bashkurti:** Dialogu në vetvete është një proces i pafund. I tillë është edhe dialogu midis Kosovës dhe Serbisë. Përcaktimi si 'faza e fundit e dialogut' nuk më është dukur asnjëherë racional. Teorikisht është e pasaktë, ndërkohë që praktikisht është shumë i nxituar. Ajo që

mund të themi është fakti se dialogu Kosovë - Serbi ka hyrë në një fazë të re, e cila synon të krijojë një marrëveshje kuadër të gjerë që do t'i hapte rrugë gradualisht normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve. Kjo fazë e re duket të jetë e gjatë, e komplikuar dhe shumë e vështirë. Janë shumë variabla që ndikojnë për këtë. Variablat brenda Kosovës, brenda Serbisë, brenda Ballkanit, brenda BE-së, variablat gjeopolitike euroaziatike dhe variablat ndërkombëtare. Siç shihet, jemi në një fazë ku lypet të konsiderohen faktorë, aktorë dhe dukuri të

shumta, dinamike dhe mjaft të paparashikueshme. Për këtë arsye përcaktimet 'faza e fundit e dialogut' apo 'faza e normalizimit' të marrëdhënieve janë shumë të diskutueshme që më shumë reflektojnë qëndrime subjektive plot keqkuptime sesa reflektojnë realitetet aktuale dhe perspektivë.

**"Epoka e re":** Qeveria e Kosovës ka formuar një ekip negociator që ende nuk ka marrë të dritën e gjelbër nga Kuvendi. A do të duhej një ekip i tillë?

**Bashkurti:** Në proceset negoci-

uese kanë rëndësi disa elemente: Së pari, është përpilimi i strategjisë së negociimit. Strategjia e negociimit ka të bëjë me tërësinë e politikave, me anën e të cilave synohet të arrihet qëllimi kryesor i negociimit dhe objektivat kryesore. Në strategji përfshihen edhe prioritetet themelore të renditura për nga shkalla e rëndësisë. Prioritetet shoqërohen me skenarët përkatës që përmbajnë pritshmëritë me avantazhet dhe disavantazhet, me përfitimet dhe humbjet, me shkallën e garancisë dhe të rrezikshmërisë. Dokumenti strategjik i negociimit përcakton edhe vijat e kuqe përtej të cilave nuk negociohet, vijat konkorduese të cilat janë tit-for-tat për tërheqje dhe lëshime si dhe vijat fleksibile, të cilat janë në çdo rrethanë pjesë e mundshme kompromisi. Dokumenti strategjik i negociimit përgatitet nga tërësia e institucioneve kushtetuese të Kosovës të ngarkuar për politikëbërje dhe vendimmarrje në politikën e jashtme. Asnjë individ dhe asnjë institucion i veçantë nuk mund ta anashkalojë këtë dokument strategjik negociimi, të përpiluar

dhe miratuar në mënyrë gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale.

Së dyti, pas përpilimit të këtij dokumenti strategjik negociues gjithëpërfshirës ndërinstitucional kalohet në miratimin e ekipit negociator dhe udhëheqësit të tij. Ekipi negociator është institucion ad-hoc i krijuar enkas për realizimin e dokumentit strategjik negociues. Ky ekip nevojitet të jetë atdhetar që jep garanci, të jetë gjithëpërfshirës që shpreh angazhim e kontribut, të jetë me integritet të lartë që krijon besim, të jetë me kulturë e profesionalitet që ushqen shpresë, të jetë me përvojë që ofron modele suksesi. Kosova ka mjaft burime të tilla, por kjo nuk do thotë se s'mund të angazhohen edhe ekspertë jashtë Kosovës.

Së treti, ekipi negociator ka shumë punë përgatitore për të bërë. Ai është hartuesi i taktikave të negociimit në proces e sipër. Ekipi ndan rolet e anëtarëve në përputhje me taktikën e negociimit. Përcakton gjuhën verbale të negociimit. Gjithashtu, përcakton gjuhë trupore dhe gestikulare. Ekipi përpilon tak-

# likuar dhe shumë e vështirë



dhe aftësi të njohura në fushën diplomatike në përgjithësi dhe të negociatave në veçanti. Kredibiliteti politik, profesionaliteti diplomatik dhe respekti ndërkombëtar janë trinomi i vlerave të kërkuara për liderin e ekipit negociator.

**"Epoka e re":** *Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj disa herë po bëjnë thirrje që në këtë fazë të fundit të dialogut të përfshihet edhe ShBA-ja. A do të duhej që ShBA-ja të ketë rol të drejtpërdrejtë në këtë dialog, jo nga prapa?*

**Bashkurti:** Presidenti, Qeveria dhe të gjitha institucionet kushtetuese politikëbërëse dhe vendimmarrëse të politikës së jashtme të Kosovës lypset ta bëjnë punën e tyre paraprake, përgatitjet respektive, të demonstrojnë legjitimitet, transparencë, përgjegjshmëri dhe gjithëpërfshirje. Mbas kësaj mund të kërkohej partnerë ndërkombëtarë mbështetës, duke përfshirë ShBA-në, BE-në apo shtetet individuale të veçanta. Këta mbeten faktorë të huaj, ndërmjetësues, lehtësues apo mbështetës. Baza ngelen institucionet sovraane dhe legjitime kushtetuese të Republikës së Kosovës. Pra, dokumenti strategjik negociues, ekipi negociator, lideri i këtij ekipi janë pjesë e detyrave dhe përgjegjësi të Kosovës. Kosova është shtet i pavarur e sovran dhe lypset të demonstrojë gatishmëri, aftësi dhe kompetenca për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, duke përfshirë edhe proceset negociuese ndërkombëtare. Gatishmëria, aftësia dhe kompetencat për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, duke përfshirë edhe proceset negociuese përbëjnë, në tërësinë e tyre, një prej katër parimeve të së drejtës ndërkombëtare për shtetin si subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare. Kosova duhet ta zbatojë këtë parim

detyruar për shtetin. Asnjë faktor ndërkombëtar, sado partner strategjik që të jetë, nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë këtë detyrim ndërkombëtar të vet Republikës së Kosovës. Transferimi i këtij detyrimi shtetëror të Kosovës te faktorë të tjerë ndërkombëtarë, qoftë edhe partnerë strategjikë, do të ishte sa i pamundur aq sa edhe tregues i paafësisë së Republikës së Kosovës për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e shtetit në marrëdhënie ndërkombëtare. Për Kosovën kjo është një sfidë e madhe. Është sfidë institucionale politikëbërëse dhe vendimmarrëse, sfidë lidhësi politik, sfidë kapacitetesh diplomatike dhe ekspertize.

**"Epoka e re":** *Z. Thaçi kohët e fundit po flet për korrigjim të kufirit me Serbinë. Ju si e keni parë këtë ide, e cila në Kosovë po kundërshtohet edhe nga një pjesë e pozitës dhe opozitës?*

**Bashkurti:** Nuk është kurrfarë ideje, as origjinale, as e re. Është një ide e vjetër sa vetë shteti. Është ideja më e komplikuar teorikisht dhe më e vështira për t'u realizuar praktikisht. Së pari, territori dhe territorialiteti nuk

janë definicione gjeografike, por gjeopolitike. Në shkencat politike thuhet se 'territori është hapësira ose mjedisi ku popujt lindin dhe zhvillojnë identitetet e veta etnokulturore dhe zhvillojnë statuset e tyre ekonomiko-sociale'. Për konsekuencë çdo lëvizje, korrigjim apo shkëmbim territori përmban ndryshim të subjektivitetit politik të popullit që jeton në atë hapësirë.

Së dyti, ndryshimi i subjektivitetit politik të popullit kërkon të konsiderohen demokratikisht të gjitha grupet, komunitetet, fiset, familjet, individët; kërkon të merren parasysh mjedisi jetues, etnokulturor, resurset ekonomike, rrethanat biznesore dhe çdo element identitar dhe statutor. Jashtë këtyre faktorëve çdo lëvizje e identitetit politik të popullit nga komunitetet deri te çdo individ do të ishte jodemokratike, do të ishte lëvizje me forcë, shpërngulje e detyrueshme dhe si të tilla të papranueshme nga parimet universale të të drejtave të njeriut.

Së treti, ndryshimet e territorialitetit, bashkë me të edhe i subjektivitetit politik të popullit respektive, nuk mund të bëhet pa marrë parasysh përvojat

historike dhe realitetet etnokulturore dhe gjeopolitike të rrethit fqinjësor të drejtpërdrejtë dhe të rajonit specifik, në rastin e dhënë të Ballkanit. Territori dhe popullsitë janë 'sisteme kapilare' me ndikime dhe efekte të pashmangshme ndërmjet tyre. Në këtë proces dihet vetëm fillimi. Fundi është i paparashikueshëm. Ajo që dihet janë vetëm përvojat historike që na japin mësim ogurzeza sidomos në Ballkan.

Së katërti, shkëmbi i territoreve dhe i subjektivitetit politik të popullit mund të ndodhë vetëm në shtetet shumë demokratike funksionale dhe që njohin e respektojnë njëri-tjetrin, vetëm në rajone krejtësisht të stabilizuara, demokratike dhe me prosperitet të lartë ekonomik e social si dhe vetëm me mbështetje dhe garanci të fuqishme dhe legjitime ndërkombëtare. Në rastin e dhënë nuk ekziston situatë e tillë as në nivelet dypalëshe shtetërore, as në mjediset rajonale dhe as në garancitë mbështetëse ndërkombëtare.

Së pesti, faza e fundit e normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi kërkohej ta synojë heqjen e kufijve ose minimalizimin e tyre; heqjen e doganave ose zbutjen e tyre; liberalizimin e lëvizjes së njerëzve dhe kontrollin e integruar të kufirit; respektimin e plotë të të drejtave të komuniteteve pakicë dhe mbi parime tërësisht reciproke; njohjen dhe pranimin reciprokisht të të vërtetave historike dhe të realiteteve aktuale midis dy shteteve. Njohja e të vërtetave prodhon respekt, respekti prodhon mirëkuptim, mirëkuptimi krijon pajtim, pajtimi krijon miqësi dhe kjo e fundit i jep fund të kaluarës, i hapë rrugë paqes, bashkëpunimit dhe prosperitetit për dy popujt dhe vendet dhe shënon vlerë të shtuar për politikën e fqinjësisë së mirë dhe për paqen e stabilitetin rajonal.

## Gjasat e Kosovës për anëtarësim në Interpol janë të zbehta

**"Epoka e re":** *Sa janë gjasat që këtë vit Kosova të pranohet në Interpol?*

**Bashkurti:** Kjo ngelet për t'u parë. Diplomacia e Kosovës po tregohet e plogësht dhe e paafte. Ajo është në krizë, sepse është mbërthyer në grackën bilaterale të lojës serbe dhe ka harruar ta vijojë agjendën e gjerë ndërkombëtare. Rënia në grackën e diplomacisë bilaterale serbe dhe lënia pas dore e agjendës së gjerë ndërkombëtare të shtetit të Kosovës po e vetizolon Kosovën, po tkurrë njohjet ndërkombëtare të saj dhe po ngadalëson integrimin, qoftë edhe në organizata të veçanta. Me zhvillimet në kohët e fundit gjasat për integrim në Interpol janë të zbehta.

titat e komunikimit me grupe të ndryshme ekspertësh, me faktorët jashtë negociatorë, me opinionin publik dhe median. Është ky ekip që hap pas hapi ofron raporte të detajuara mbi ecurinë e procesit të negociimit në përputhje me dokumentin strategjik negociues.

Së katërti, në krye të ekipit negociator vihet një personalitet me vlera, besim, kulturë

## Thaçi përsërit: Nuk ka pasur më shumë se 15 mijë luftëtarë me armë dhe uniformë

**Prishtinë, 4 tetor (ER)** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ripërsëritur se hetimit për veteranët e UÇK-së duhet t'i shkohet deri në fund përmes drejtësisë dhe jo kërcënimeve apo presionit politik prej kujtqo qoftë që vjen pasi, sipas tij, nuk ka pasur më shumë se 12 deri në 15 mijë njerëz me armë dhe uniformë. "Ne të gjithë duhet ta inkurajojmë sistemin e drejtësisë që kësaj çështje

t'i shkojë deri në fund, me një transparencë dhe përgjegjësi të plotë. E vërteta është shumë e qartë: nuk ka pasur më shumë se 12, 15 mijë njerëz me armë dhe uniformë, ndërsa të tjerët janë vetëm mashtrime, prandaj këtij mashtrimi të madh me humbje të buxhetit të Republikës së Kosovës duhet t'i shkohet deri në fund përmes drejtësisë dhe jo kërcënimeve apo presionit politik prej

kujtqo qoftë që vjen", ka thënë Thaçi

Këto komente presidenti i Kosovës i ka bërë gjatë punimeve të konferencës dyditore rajonale kundër korrupsionit, të organizuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, ku po marrin pjesë drejtues të institucioneve relevante nga Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Italia, Kroacia, Mali i Zi, Moldavia, Turqia.



## Ministri Ismaili: Do të jemi pranë nënave dhe fëmijëve edhe përmes vizitave në shtëpi

GJILAN, 4 TETOR (ER) - Në Komunën e Gjilanit është mbajtur takimi i rregullt i infermiereve të cilat realizojnë vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave infermierike gjatë vizitave në shtëpi si dhe monitorimi i rezultateve të arritura gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti. Në këtë takim pjesëmarrës ishte edhe ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili. Ai ka thënë se që nga fillimi i mandatit të tij ky projekt ka qenë një ndër të cilët e ka bindur se duhet të përkrahët dhe të rritet

edhe më tutje. "Unë do të jem i gatshëm ta ofroj gjithë mbështetjen time që këto vizita në shtëpi për nëna dhe fëmijë të zhvillohen dhe të rriten. Nënata dhe fëmijët nuk kanë askënd më shumë sesa ju. Prandaj, ne e vlerësojmë punën e palodhshme që ju e bëni dhe ndihmën që ua bëni nënave dhe fëmijëve, dhe kërkojmë nga ju ta mbani dinamikën për të ofruar këto shërbime", ka deklaruar ministri Ismaili. Ai i ka siguruar infermierët dhe koordinatorët e vizitave në shtëpi se nuk do të jenë vetëm për ofrimin e këtyre shër-

bimeve.

Më tutje, ministri Ismaili ka thënë se do të diskutojë edhe me kryetarët e komunave që këto vizita të mos lejohen të bien në numër, por të rriten edhe në vëllim dhe cilësi. "Unë do t'u shkruaj edhe kryetarëve të komunave për ta ofruar mbështetjen e këtij projekti. Mos lejoni të dështojë ky projekt, sepse nënat dhe fëmijët kanë nevojë për ju. E pranë jush do të jemi ne", është shprehur ai.

Gjatë këtij viti janë realizuar 7 936 vizita në shtëpi. Këto vizita aktualisht zhvillohen në 14



komuna: Prizren, Dragash, Gjakovë, Fushë-Kosovë, Lipjan, Obiliq, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Viti, Shtime, Dardanë, Kaçanik

dhe Hani i Elezit. Deri në fund të këtij viti nga këto vizita pritet të përfitojnë edhe Drenasi, Vushtrria dhe Skenderaj.

## Panairi Vjeshtor i Librit AAB 2018, cilësohet më i miri në rajon

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 TETOR - Me një ceremoni solemne në Kolegjin AAB të enjten është bërë hapja e edicionit të parë të Panairit Vjeshtor AAB 2018, ngjarje kjo e cila do të pasojë edhe në ditët në vijim. Hapjen e panairit e ka bërë rektori i Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, i cili para të pranishmëve ka theksuar se AAB tashmë i ka dhuruar Kosovës shumë ngjarje kulturore dhe artistike, por se kjo e sotshmja është e një rëndësie të veçantë pasi që në fokus ka studentin. "Ne kemi panairë që mbahen në ambiente shqiptare, si ai i pranverës në Prishtinë, i nëntorit në Tiranë e të tjerë, por nuk kemi pasur një panair ku libri i ofrohet studentit. Prandaj, edhe qëllimi i këtij panairi është që librari të jetë një me lexuesin. Studenti nuk është një lexues si të gjithë të tjerët, por është një lexues që leximin e ka jo vetëm pasion, por edhe detyrim. Kjo e bën të veçantë këtë panair", ka thënë rektori Tafa.

Ai ka theksuar se pjesë e këtij panairi, përveç studentëve të Kolegjit AAB, hapësirë për pjesëmarrje do të kenë edhe vizitorët e tjerë nga vendi e rajoni, ku me këtë rast do të mund të gjejnë libra të zhanreve të ndryshëm që ky panair i librit ofron këtë vit. "Edhe pse mbahet në ambiente



universitare, ky panair nuk ka kufizime, por është i hapur për të gjithë adhuruesit e librit që dëshirojnë të shijojnë atë që ofron libri të cilin ju dhe ne sot e ofrojmë për lexuesit", ka thënë rektori Tafa. Hapjen e panairit e ka përshëndetur edhe zëvendësmministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

Leonora Morina-Bunjaku, e cila ka përgëzuar Kolegjin AAB për organizimin e kësaj ngjarjeje me rëndësi të madhe për dashamirësit e librit. "Një përgëzim i veçantë për këtë aktivitet shumë të rëndësishëm i cili nuk duhet të konsiderohet një aktivitet fjalimesh, por leximesh, i

cili duhet të krijohet si një traditë në të gjitha familjet si pjesë e komunitetit dhe shoqërisë së Kosovës. Sot si kurrë më parë lexuesit kanë mundësi të shumta që të shërbehen me libra të fushave të ndryshme", ka thënë Morina-Bunjaku.

Panairi i Librit AAB 2018 do të jetë

i hapur për vizitorë deri më 7 tetor nga ora 10:00 deri në orën 18:00, ndërsa qindra tituj e mijëra ekzemplarë nga rreth 50 botues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia do të jenë në dispozicionin tuaj me oferta të veçanta. Të gjitha shtëpitë botuese, pjesëmarrëse të edicionit të parë të Panairit AAB 2018, u shprehën të befasuara me organizimin dhe ambientet e panairit të sivjetmë, duke e krahasuar edhe me panairë ndërkombëtare.

### Në Panairin Vjeshtor të Librit AAB 2018 promovohet libri "Takimi në Junik"

Në kuadër të këtij panairi të enjten është bërë edhe promovimi i librit "Takimi në Junik". Autori i këtij libri, Hajdin Abazi, ka falënderuar të gjithë për pjesëmarrje në promovimin e librit të tij. "Ishte një audiencë shumë e çmuar. Ju faleminderit të gjithëve!", ka shkruar Hajdin Abazi në llogarinë e vet në "Facebook".

## Kërkohet ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje në objektet e institucioneve publike

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Nën udhëheqjen e koordinatit të Task Forcës për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, ushtruesit të detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, është mbajtur të enjten takimi i radhës i Task Forcës për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Gjatë këtij takimi, me propozim të

Matoshit, përfaqësuesit ndërmëtorë të Task Forcës kanë aprovuar propozimvendimin për ndalimin e përdorimit të thëngjillit për ngrohje në objektet e institucioneve publike, i cili do të procedohet për miratim në Qeveri. Matoshi ka thënë se vendimi për ndalimin e përdorimit të thëngjillit për ngrohje në objektet e insti-

tucioneve publike ka për qëllim reduktimin e ndotjes së ajrit. Në konferencën për media të mbajtur pas këtij takimi, ministri Matoshi ka prezantuar hapat që MMPH-ja është duke ndërmarrë për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vend, veprimet e Task Forcës dhe ministrive anëtare të kësaj Task Force.



Bashkimi Evropian (BE) dhe OSBE-ja kanë mbajtur punëtorinë e përbashkët me temën "Financimi i partive politike"

## BE-ja dhe OSBE-ja kërkojnë transparencë nga partitë politike

Zyrtarët e Bashkimit Evropian dhe të Misionit të OSBE-së në Kosovë kanë bërë me dije se partitë politike në Kosovë i fshehin financat e tyre. Në punëtorinë e tyre të përbashkët me temë "Financimi i partive politike", zyrtarët e këtyre misionëve ndërkombëtare kanë kërkuar rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies prej subjekteve politike



EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 4 TETOR** - Zyra e Bashkimit Evropian (BE) dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë kanë kërkuar nga partitë politike të jenë më llogaridhëse dhe transparente. Në punëtorinë me temë "Financimi i partive politike" të organizuar nga BE-ja dhe OSBE-ja, zyrtarët e këtyre misionëve kanë deklaruar se deri më tani subjektet politike kanë dështuar ta sigurojnë llogaridhënien.

Riccardo Serri nga Zyra e BE-së ka përmendur të gjeturat e auditorit në zgjedhjet e fundit dhe transparencën e partive politike, duke thënë se ato nuk janë aspak inkurajuese. "Në Kosovë ka nevojë urgjente për t'i kontrolluar financat politike, transparencat mbi donacionet dhe shfrytëzimin. Këto janë disa probleme që janë gjetur nëse i shohim raportet e auditorëve. Gjetjet janë goxha

bregosëse. Sipas auditorëve të pavarur që kanë kryer këto shqyrtime, partitë politike kanë dështuar ta sigurojnë llogaridhënien, raportim të brendshëm, raportim financiar dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore sa iu përket financave të tyre", ka thënë Serri.

Sipas tij, shumë parti politike në Kosovë nuk i kanë raportuar sa duhet një pjesë të shpenzimeve të tyre. "Gjithashtu, është shqetësuese që auditorët nuk kanë arritur të identifikojnë goxha shuma të mëdha të të hyrave të shumë partive politike. Shumë dokumente nuk kanë qenë të sakta ose adekuate. Prandaj, është shumë mirë që auditimi ka ndodhur", ka deklaruar ai.

Kurse drejtori i Departamentit të Demokratizimit në OSBE, Christopher Tuetsch, ka pasur një rekomandim për gjambat e vendosura nga KQZ-ja dhe PZAP-ja. "Dënimet për partitë politike nuk duhen zbritur nga

fondi që ndahet nga buxheti Kosovës apo ndonjë fond që ndahet për partitë politike, përndryshe ky nuk është dënim sepse ky paguhet nga shoqëria", ka thënë Tuetsch. Ndërsa kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka deklaruar se ndryshimi i Ligjit për zgjedhjet do të mund ta rregullonte transparencën në parti politike. "Unë kisha dashur ta potencoj rëndësinë që ka miratimi i këtij ligji. Ky ka qenë rekomandimi edhe i vëzhguesve ndërkombë-

tarë pasi që vërejtja kryesore ka qenë se partitë politike nuk kanë qenë transparente", ka thënë Daka.

Në këtë punëtori ka marrë pjesë edhe Isabelle Servoz-Gallucci, shefe e Zyrës së Këshillit të Evropës. Ajo ka thënë se komisioni i Venecias ka dhënë një kontribut shumë të madh për Kosovën për vite me radhë, posaçërisht duke dhënë mendime për institucione demokratike. Sipas saj, e veçanta e kësaj punëtorie është

fakti se ka qenë kërkesë e autoriteteve të Kosovës, për herë të parë drejtpërdrejt nga kryeministri. "Nga 61 shtete, Kosova është anëtare me kompetenca të plota. Nuk ka të bëjë vetëm me Kushtetutën, por me nevojat e përbashkëta ligjore. Ka të bëjë me rreshtimin me standardet evropiane që ndihmon për shpërndarjen e trashëgimisë kushtetuese që është përfituese për të gjitha palët", ka thënë Servoz-Gallucci.

## Tahiri: Shumë sondazhe tregojnë se qytetarët nuk besojnë në gjyqësor

**TIRANË, 4 TETOR (ER)** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë të premten në Forumin Ministror BE - Ballkani Perëndimor për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, të organizuar nga Presidenca Austriake e Këshillit të Bashkimit Evropian që po mbahet në Tiranë.

Gjatë adresimit të tij para homologëve, ministri Tahiri ka theksuar se i gjithë regjioni është në përmbyllje të tranzicionit dhe po bën progres, sidomos për përmirësimin e sektorit të drejtësisë. "Si ministër i Drejtësisë së Kosovës jam plotësisht i vetëdijshëm se kemi nevojë për përmirësimin e kualitetit të drejtësisë. Andaj kam ndërmarrë hapa të rëndësishëm dhe reforma të rëndësishme ligjore për ta rritur qasjen në drejtësi, efikasitetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë e sektorit të drejtësisë", ka thënë ministri Tahiri. Ai ka

përmendur ndryshimet konkrete ligjore të bëra gjatë një viti të mandatit të tij.

Sipas Tahirit, ndryshime në këtë sektor pritet të bëhen edhe përmes reformës së ndërmarrë të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, si dhe agjendës së përbashkët me Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial, "Drejtësia 2020". "Reformat që kemi ndërmarrë na japin shpresë se drejtësia jonë ka një të ardhme dhe ne jemi të përkushtuar për të parë që kjo e ardhme të ndodhë tani. Por, ne kemi ende shumë punë për të bërë. Realiteti nganjëherë nuk na ndjek ashtu si e presim. Shumë sondazhe tregojnë se qytetarët nganjëherë nuk besojnë në gjyqësor, si shtylla më e rëndësishme e sistemit të drejtësisë. Andaj, me këto reforma kemi dëshmuar se kemi vullnet të balafaqohemi me këto sfida, për ta avancuar sundimin e ligjit, luftën



kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, për ta përmirë-

suar qasjen në drejtësi dhe për të mundësuar shërbime të mira

gjyqësore për qytetarët tanë", ka theksuar ministri Tahiri.

# Bizneset kanë nevojë t'i rrisin kapacitetet e tyre për të përfituar nga IPA



PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Fondet e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) përbëjnë një mundësi të rëndësishme në rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian e, po ashtu, një element i rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes financiare ndaj sektorit privat në Kosovë. Kështu u tha të enjten në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), me qëllim të informimit të bizneseve mbi procedurat e aplikimit për Fondet IPA si dhe përfitimet të cilat dalin nga ofrimi i kësaj mbështetjeje. Ferida Zeka, zyrtare e lartë për Zhvillim Ekonomik në Ministrinë e Integritimit Evropian, ka thënë se fondet IPA janë mekanizmi

përmes të cilit BE-ja ofron mbështetje financiare dhe asistencë teknike për shtetet kandidate dhe shtetet kandidate potenciale. Zeka ka sqaruar se, krahas reformave shtetërore, për anëtarësim në BE duhet qeverisje e duhur, sundim i ligjit, konkurrenshmëri, rritje të cilësisë në edukim, bujqësi, politika mjedisore e shumë të tjera. "Fondet IPA II kanë rëndësi të veçantë edhe për sektorin privat në vend", ka thënë ajo, duke sqaruar se ofrimi i mbështetjes së fondeve IPA bëhet në bazë të identifikimit të nevojave në sektorë të ndryshëm, ku dhe bëhet përcaktimi i prioritetëve për mbështetje financiare në fusha të caktuara.

Kure Rexhep Vasolli, drejtor i

Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave nga Ministria e Financave, ka thënë se Ministria e Financave në aspektin rregullativ të marrëveshjes së nënshkruar në mes të BE-së dhe Kosovës synon sigurimin e pjesës së bashkëfinancimit. Ai ka shtuar se pavarësisht prej strukturave të krijuara nga Qeveria e Kosovës për adresimin e prioritetëve për financim nga fondet IPA, Kosova ka përfituar mjaft pak, duke përmendur se Kosova ka qasje në dy komponentë në kuadër të IPA 2, në bashkëpunimin ndërkuftar dhe ngritjen e kapaciteteve në asistencë teknike si dhe mbështetjen buxhetore sektoriale.

Më tej, Vasolli ka njoftuar të pranishmit me kushtet të cilat duhet të përmbushen për t'u kualifikuar për mbështetje nga fondet IPA si dhe për përfitimet të cilat Kosova i ka marrë nga kjo marrëveshje në të kaluarën, duke konkluduar se aktualisht Kosova është duke përfituar dy mbështetje për modernizimin e administratës publike me asistencë teknike dhe, po ashtu, edhe në fushën e menaxhimit të financave publike.

Irfan Lipovica, drejtor i Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka deklaruar se bizneset në Kosovë kanë nevojë t'i rrisin kapacitetet e tyre për të

përfituar nga skemat dhe projektet e financuara përmes fondeve të IPA-s. Ai ka sqaruar se skemat e granteve, ku përfitues është sektori privat, në të shumtën e rasteve kanë për synim ngritjen e konkurrenshmërisë së bizneseve, në veçanti të bizneseve prodhuese, ku prioritet u jepet atyre projekteve me ndikim në rritjen e punësimit dhe eksporteve.

Bizneset e pranishme kërkuar që institucionet e vendit të jenë më përkrahëse ndaj bizneseve në aspekt të informimit të tyre për mundësitë e shfrytëzimit të fondeve IPA, që do të mundësonte absorbim më të mirë të fondeve me qëllim të vënies së tyre në funksion të zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës.

## Ministri Shala: Do t'i mbrojt prodhuesit nga importi i pabarabartë



PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se do ta përdorë të gjithë peshën e tij politike që t'i shtyjë përpara proceset që janë në të mirë të bizneseve vendore. Shala ka thënë se ka kërkuar informacione të detajuara nga të gjitha departamentet për ta parë se ku jemi me prodhimin vendor dhe ku mund t'i ndihmojë MTI-ja. "Kam kërkuar nga drejtorët e

departamenteve dhe udhëheqësit e agjencive të kem informacionin se si jemi në raport me prodhimin vendor dhe ku ne si MTI mund t'i ndihmojmë dhe përkrahim prodhuesit vendor, me masa mbrojtëse në raport me importin e pabarabartë që po u bëhet prodhuesve tanë", ka deklaruar ai.

Ministri Shala ka thënë se do ta rrisë dinamikën e punës dhe do

të ketë prioritet ndihmën ndaj prodhuesve vendorë sepse, sipas tij, janë promotori kryesor i zhvillimit ekonomik të Kosovës. "Do të jem në dispozicion të bizneseve vendore dhe do të merrem me hallet e tyre, sepse konsideroj se janë promotorë të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Me një fjalë, e mbajnë gjallë ekonominë e vendit tonë", ka thënë Shala.



# BB-ja: Rritja ekonomike në Kosovë pritet të stabilizohet në 4.2 për qind

Sipas raportit të rregullt ekonomik të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, në Kosovë rritja ekonomike pritet të stabilizohet në 4.2 për qind në vitin 2018. Sipas këtij raporti, apelohet edhe për integrim më të madh ekonomik për të nxitur një rritje më të lartë dhe të qëndrueshme si dhe për të stimuluar krijimin e vendeve të reja të punës



cenueshmëritë fiskale. Rritja e investimeve private dhe e eksporteve është mënyrë më e qëndrueshme e rritjes", ka thënë Linda Van Gelder, drejtoreshë Rajonale e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor.

Në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, borxhi i lartë publik, cili vazhdon e rritet, shoqërohet me pabarazitë fiskale dhe të jashtme, duke e bërë perspektivën të cenueshme ndaj rritjes së kostove të financimit nëse do të shtrëngohen tregjet financiare. Mbështetja e rritjes afatgjatë kërkon reforma të brendshme që i gufojnë investimet private dhe eksportet.

Raporti bën thirrje edhe për integrim më të madh ekonomik për të nxitur një rritje më të lartë dhe të qëndrueshme dhe për ta stimuluar krijimin e vendeve të punës. Kërkohet rritje e integritimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke u fokusuar në tregti, investime, lëvizshmëri dhe integrim digjital, për ta përsheptuar rritjen, për t'i kapërcyer tregjet kombëtare të vogla dhe të fragmentuara dhe për të siguruar stabilitet afatgjatë ekonomik.

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 TETOR - Përfaqësuesit e Bankës Botërore në Kosovë (BB) kanë mbajtur të enjten konferencë për medie në të cilën kanë prezantuar raportin e rregullt ekonomik të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor. Rritja për rajonin e Ballkanit Perëndimor vlerësohet të konsolidohet në 3.5 për qind për vitin 2018, sipas Raportit të Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor "Rritje më e lartë por e brishtë". Sipas vlerësimeve, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia rriten me ritme mes 2.5 dhe 4 për qind.

Bazuar në këtë raport në Kosovë, rritja e fortë pritet të stabilizohet në 4.2 për qind në vitin 2018. "Rritja parashikohet të arrijë në 4.5 për qind në periudhën 2019-2020, por perspektiva është e cenueshme nga rreziqe të jashtme dhe të brendshme. Deficiti fiskal parashikohet të rritet brenda kufijve të rregullës fiskale, për shkak të investimeve më të larta publike, kryesisht në infrastrukturë dhe shpenzimeve të pashënjestruara për mbrojtje sociale", është potencuar në raport.

Marco Mantovanelli, menaxheri i Bankës Botërore për Kosovën, ka thënë se rritja po ruan një momentum pozitiv dhe politika fiskale mbetet në përputhje me rregullën fiskale. "Është thelbësore

të përmirësohet alokimi i shpenzimeve për të investuar në kapitalin njerëzor dhe fizik, për një rritje më të shpejtë dhe të qëndrueshme. Kosova po tregon një absorbim më të mirë të investimeve të financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe performancë më të mirë të eksporteve, por perspektiva mund të cenohet nga paqëndrueshmëria politike, rritjet e mëtejshme të përfitimeve të pashënjestruara dhe rënia globale e tregtisë dhe hyrjeve të kapitalit", ka deklaruar Mantovanelli. Edhe punësimi u rrit në pesë nga gjashtë vendet në rajon, 91 400 vendet e reja të punës të krijuara mes korrikut 2017 dhe korrikut

2018 ishin dukshëm më pak se 214 000 vendet e punës të shtuara një vit më parë. Shumica e vendeve të reja të punës shfaqen në sektorët e industrisë dhe shërbimeve.

Ndërkaq Linda Van Gelder, drejtoreshë Rajonale e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, ka thënë se në mbarë rajonin po shohin rritje të mbështetur nga investimet dhe shpenzimet publike. "Vendet që kanë dëshmuar rritjen e investimeve të tyre private, kanë dëshmuar edhe një rritje më të shpejtë. Megjithatë shpenzimet e pashënjestruara sociale dhe pagat publike kanë ndikuar pozitivisht në rritjen afatshkurtër, ato zmadhojnë



## Hamza vlerëson mbështetjen e Gjermanisë për Kosovën

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka zhvilluar të enjten një takim me delegacionin gjerman të udhëhequr nga sekretarët e Shtetit, Maria Flachsbarth dhe Thomas Silberhorn, me rastin e vizitës së tyre në Kosovë. Ministri Hamza ka falënderuar delegacionin për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania ka

ofruar drejt zhvillimit të përgjithshëm ekonomik e social të Kosovës.

Në veçanti, ministri ka falënderuar sekretaren e Shtetit për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Maria Flachsbarth, për bashkëpunimin tejet të frytshëm me Ministrinë e Financave si bashkëpunëtorë kyç. Gjithashtu, ai i ka shprehur falën-

derim edhe sekretarit të Shtetit për Mbrojtje, Thomas Silberhorn, për iniciativën e përbashkët për transformim të Kampit të KFOR-it gjerman në Prizren në një Park Inovacioni që do t'u shërbejë bizneseve dhe qytetarëve të Kosovës.

Duke njohur sukseset e përbashkëta në lidhje me bashkëpunimin zhvillimor në

mes të dy vendeve, ministri Hamza ka theksuar se projektet që janë realizuar së bashku, ai i kognitimit për Termokosin, furnizimi me ujë të pijes në Prishtinë, trajtimi i ujërave të zeza në pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe eficientia e energjisë, kanë ndikuar dhe do të vazhdojnë të ndikojnë në masë të madhe për përmirësimin e kualitetit të jetës

së qytetarëve të Kosovës.

Sekretarja e Shtetit, Maria Flachsbarth, ka falënderuar ministrin Hamza për marrëdhëniet profesionale dhe të besueshme mes dy qeverive, duke theksuar se Gjermania mbetet e përkushtuar që ky bashkëpunim i shkëlqyer të vazhdojë edhe me projektin e veçantë të Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren.

## Prokuroria e Gjakovës ka ngritur nëntë aktakuza për rastet e dhunës në familje

GJAKOVË, 4 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë muajit shtator ka pranuar shtatë raste të cilësuar si dhunë në familje, gjegjësisht vepra penale nga neni 188/3 të KPK-së. Për të gjitha rastet është marrë aktvendim për fillim të hetimeve dhe është caktuar paraburgimi i shtatë të pandehurve. Ndaj tyre është duke u zhvilluar procedura hetimore. Gjithashtu, gjatë muajit shtator janë ngritur nëntë aktakuza për rastet e dhunës në familje nga neni 188/3 të KPK-së. "Prokuroria Themelore në Gjakovë është e angazhuar t'i kryejë me seriozitet të lartë të gjitha rastet, sidomos ato raste që kanë të bëjnë me dhunën në familje", është thënë në njoftimin për media të kësaj prokurorie.



## Sot bëhet inaugurimi i Kompleksit Memorial të Dëshmorëve në Marinë

SKENDERAJ, 4 TETOR (ER) - Nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe të kryetarit të Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, sot

(e premte) në orën 11:00 do të bëhet inaugurimi i Kompleksit Memorial të Dëshmorëve në Marinë dhe, me përcjelljen e gardës ceremoniale të FSK-së,

do të bëhet rivarrimi i heronjve të kombit, komandantëve dhe kolosëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Ilaz Kodra, Mujë Krasniqi dhe Abedin Rexha.



## Shkaktohen disa zjarre fushore në Malishevë, apelohehet për kujdes të shtuar

MALISHEVË, 4 TETOR (ER) - Në territorin e Komunës së Malishevës kanë ndodhur disa zjarre fushore, ndërsa njësisia e zjarrfikësve e Malishevës ka intervenuar në tri zjarre të mëdha fushore. Me këtë rast, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka apeluar te qytetarët që të bëjnë kujdes të shtuar. Në disa raste këto zjarre fushore kanë rrezikuar të

përhapen në masë dhe duke rrezikuar djegien e pyjeve dhe të shtëpive, por duke iu falënderuar ndërhyrjes së njësisë së zjarrfikësve, janë shuar këto zjarre. Bashkë me njësitë e zjarrfikësve në këto incidente zjarri kanë intervenuar edhe njësitë e policisë dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim. Drejtori i Drejtorisë për

Mbrojtje dhe Shpëtim, Valon Gashi, në emër të drejtorisë ka apeluar te qytetarët që të bëjnë kujdes të shtuar dhe të mos shkaktojnë zjarre në fusha, qoftë nga hedhja e cigareve apo edhe nga djegia e hamulloreve dhe barit të thatë pasi, për shkak të thatësisë së madhe, zjarret përhapen shpejt dhe nuk mund të kontrollohen.

## Së shpejti në Vushtrri do të hapen mbi 100 vende të reja të punës

VUSHTRRI, 4 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka mbajtur të enjten takim me investitorët e kompanisë "Bisek" nga Polonia, një nga kompanitë lidere në Evropë në fushën e minierës si dhe me banorët e Galicës dhe Dubovcit. Tahiri ka bërë me dije se së shpejti në Vushtrri do të ndodhë investimi i huaj në minierën e Dubovcit e Galicës. "Vlera e këtij investimi është 5 milionë euro brenda shtatë vjetëve të para. Nga ky investim pritet të krijohen mbi 100 vende të reja të punës", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se Qeveria ka aprovuar shpronësimin e pronave të banorëve. "Komuna është e përkushtuar për të krijuar ambient të sigurt për investime të huaja", ka thënë Tahiri.



# A PO LINDË SERBIA E PUTINIT?



Milazim KRASNIQI

Vizita e Vuçiqit në Rusi kaloi, dilemat mbeten, pasojat do të fillojnë të shihen në javët në vazhdim, kur do të fillojnë të zbatohen urdhrat e Putinit. Mbase urdhrat mund të bëhen më të qarta gjatë vizitës së Putinit në Beograd, që pritet të zhvillohet gjatë nëntorit të këtij viti. Por, edhe para asaj vizite, mund të fillojë një ofensivë e re serbomadhe kundër Kosovës, sepse ajo tashmë është akorduar në Moskë. Vuçiqi ka deklaruar vetë se nga 50 minu-

tat që kanë biseduar kokë më kokë me Putinin, 40 minuta i janë kushtuar Kosovës, gjë që lë të kuptojë se ata kanë përpunuar një plan të detajuar për veprim në të ardhmen. Nëse ka të vërtetë në konstatimin e gazetës ruse "Komersant" se Putini nuk është pajtuar me idenë e Vuçiqit për "zagranicenje", pra për aneksimin e veriut të Kosovës, me çka do të hapet mundësia e njohjes së Kosovës së amputuar, atëherë zhvillimet e ardhshme mund të jenë pritshme. Zhvillimet e pritshme do të ishin që Rusia të involvohej më shumë në zhvillimet në Kosovë, duke ia marrë Serbisë primatin e angazhimit. Pra, de facto Rusia do të ishte palë në procesin e negociatave dhe në gjithë menaxhimin e konfliktit ndërmjet Serbisë e Kosovës. Si duket Putini ka konstatuar se Serbia nuk ka energji

të përballojë presionet në rritje të Brukselit, prandaj do të shfaqet Rusia si tutor i saj në gjithë procesin, duke amortizuar presionet e Perëndimit mbi Serbinë. Pse mund ta marrë Rusia këtë rol, duke shmangur në plan të dytë Serbinë? Pse nuk e ka lejuar Serbinë të tentojë të marrë atë që synon dhe të mbyllet konflikti asfiksues ndërmjet Serbisë e Kosovës, si edhe ndërmjet Serbisë e Brukselit dhe Uashingtonit? Ka disa arsye. E para, Ruisë i konvenon që lidhur me Kosovën Serbia të mbetet e varur nga vota e saj në Këshillin e Sigurimit, sepse ashtu e mban në raport vasaliteti. Kjo varësi e Serbisë mund ta detyrojë ta avancojë Qendrën Humanitare Serbo-Ruse në Nish, në një bazë ruse në të ardhmen. Nëse do të ndodhte kjo, atëherë Rusia do t'i futej në brendësi

Aleancës Veriatlantike. Në një zhvillim të tillë, Ukraina do të mbetet e gozhdur përgjithmonë në kthetrat ruse. Pra, Ruisë i duhet konflikti ndërmjet Serbisë e Kosovës, për planet e veta gjeopolitike e gjeostrategjike. E dyta, mbetja e konfliktit ndërmjet Serbisë e Kosovës, pamundëson anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian, gjë që po ashtu është interes strategjik i Ruisë. Një Serbi jashtë BE-së, do të kishte më shumë nevoja për ndihmat ruse, do të varej më shumë nga Rusia. E treta, deri sa vazhdon të jetë i hapur konflikti ndërmjet Serbisë e Kosovës edhe Bashkimi Evropian do të mbetet i përçarë në këtë çështje, ngase pesë shtete anëtare të BE-së nuk e njohin Kosovën si shtet. Mungesa e unitetit të Bashkimit Evropian, i konvenon shumë Ruisë, prandaj

ajo punon që kjo përçarje të vazhdojë, mundësisht edhe të thellohet. E katërta, Rusia po e shfrytëzon në maksimum konfuzionin e administratës amerikane, për të penetruar sa më shumë në Ballkan, duke u çimentuar në Serbi, duke destabilizuar keqas Maqedoninë e duke rritur çdo ditë kontestimin ndaj shtetit të Kosovës. Nëse ndihmojnë simbolikat në këso analizash, atëherë edhe fakti që Vuçiqi gjatë tërë takimit me Putinin kishte folur vetëm rusisht, mund të jetë indikacion që Serbia po shkon drejt shndërrimit të pakthyeshëm në satelit rus. Thënë thjesht, Serbia e Vuçiqit po shndërrohet në Serbi të Putinit. Serbisë së Putinit pritet t'i rikthehet roli i zjarrvënësës së Ballkanit, kësaj here për hesapet ekskluzive të Ruisë. Në dem edhe të vetë Serbisë. (4 tetor 2018)

## Vihet gurthemeli i Shkollës së Mesme Profesionale në Ferizaj



**FERIZAJ, 4 TETOR (ER)** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka qëndruar të enjten në qytetin e Ferizajt, ku ka vizituar Qendrën e Kompetencës në këtë komunë dhe ka vënë gurthemelin e Shkollës së Mesme Profesionale së bashku me kryetarin e komunës, Agim Aliu, me të cilin edhe ka pasur një takim ku ka biseduar për bashkëpunimin në fushën e arsimit. Me këtë rast ministri Bytyqi ka shprehur kënaqësinë për punën që po bëhet për

përgatitjen e nxënësve për tregun e punës në Qendrën e Kompetencës dhe, po ashtu, edhe për vënien e gurthemelit të shkollës profesionale, për të theksuar më pas rëndësinë që ka arsimit dhe aftësimi profesional në të ardhmen e të rinjve tanë dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Sa i përket Qendrës së Kompetencës, ministri e vlerësoi si një shkollë model, ndërsa uroi qytetarët e Ferizajt për fillimin e ndërtimit të shkollës së re, për të cilën tha se do t'u

krijojë mundësi nxënësve që në kushte shumë më të mira ta marrin kompetencën dhe dijen e nevojshme. "Ne jemi zotuar edhe si ministri, por besoj edhe pushteti lokal që të angazhohemi që të rinjve tanë t'u sigurojmë jo vetëm një edukim të mirë, por edhe një orientim të drejtë për të ardhmen e tyre", ka thënë Bytyqi. Ai ka vlerësuar se shkollat profesionale janë një orientim i mirë dhe i drejtë. Bytyqi ka pohuar se kjo është edhe arsyeja pse MASH-T-i e ka

vendosur si prioritet arsimin profesional, pra zhvillimin e shkollave profesionale, ndërtimin e tyre, si dhe bashkëpunimin me pushtetin lokal dhe bizneset. Ministri Bytyqi ka shprehur gatishmërinë që gjithmonë të jenë afër dhe ta ndihmojnë Komunën e Ferizajt jo vetëm me projekte të tilla, por edhe

në forma të tjera që do të kontribuonin në ngritjen e cilësisë në arsim. Kjo vizitë e ministrit Bytyqi në Ferizaj është bërë në vazhdim të vizitave që po u bënë komunave, respektivisht shkollave të Kosovës, për t'i bashkërenduar aktivitetet dhe për ta fuqizuar bashkëpunimin për ndryshim të gjendjes në arsim.

## Librashitësit shkojnë në zyrën e kryetarit të Prishtinës

**PRISHTINË, 4 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka pritur të enjten në takim librashitësit e sheshit të Prishtinës. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se komuna do të gjejë mënyra për t'i përkrahur librashitësit. "Pas

ftesës mbrëmë, Florimi dhe librashitësit e tjerë ishin sot në zyrë. Edhe pse qiraja e ulët, pagesa e kësaj shume ishte tema kryesore. Me rëndësi askush nuk e largon askënd e ne do të gjejmë mënyra ta vazhdojmë përkrahjen e librit", ka shkruar Ahmeti.



## Merkeli viziton vendin përkujtimor të hebrenjve në Jerusalem

TEL-AVIV, 4 TETOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel është përlurur me nderime para gjashtë milionë hebrenjve në Izrael, të vrarë nga nazistët dhe ka thënë se Gjermania mban përgjegjësi për ta luftuar antisemitizmin dhe të mos harrojë kurrë Holokaustin, transmeton "Reuters". Ajo ka nisur takimet në mes të delegacionit të Qeverisë gjermane dhe asaj izraelite me një vizitë në vendin përkujtimor të Holokaustit

në Izrael, Yad Vashem. "Pothuajse 80 vjet më parë, në natën e 9 nëntorit, hebrenjtë në Gjermani janë përballur me urrejtje dhe dhunë të paimagjineshme. Kjo është përcjell me krime të pashembullta kundër civilëve në formë të Shoahs", ka thënë ajo duhet përdorur shprehjen hebreje për Holokaustin. "Gjermania ka përgjegjësi për t'i kujtuar këto krime dhe për të luftuar antisemitizmin, ksenofobinë, urrejtjen dhe

dhunën", është shprehur ajo. Merkel ka arritur në Izrael të mërkurën për një vizitë 24 orëshe, në kuadër të takimeve vjetore në mes të ministrave gjermanë dhe atyre izraelitë. Partia e konservatore e kancelares Merkel është nën presion nga nacionalistët dhe e djathta ekstreme në Gjermani, të cilët janë zemëruar pas vendimit të saj për të pranuar më shumë se 1 milion azilkërkues më 2015 në Gjermani.



## Pse ShBA-ja injoron vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare

Gjykata Ndërkombëtare në Hagë tha se sanksionet e Shteteve të Bashkuara kundër Iranit nuk duhet të prekin eksporte të të mirave materiale bazë si ilaçet, ushqimet apo aparatura që garantojnë sigurinë e fluturimit ajror. Por ShBA-ja kishte deklaruar se kjo gjykatë nuk është përgjegjëse për çështjen

WASHINGTON, 4 TETOR - Gjykata Ndërkombëtare në Hagë tha se ShBA-ja duhet të heqë një pjesë të sanksioneve kundër Iranit. Kjo vlen për masat që Qeveria amerikane mori më 8 maj 2018. Argumenti i gjykatësve të Gjykatës Ndërkombëtare: Disa sanksione prekin drejtpërdrejt popullsinë civile në Iran. Sanksionet nuk duhet të prekin eksporte të të mirave materiale bazë si ilaçet, ushqimet apo aparatura që garantojnë sigurinë e fluturimit ajror. Kështu për shembull transporti ajror civil i Iranit nuk duhet të preket nga sanksionet, vendosën

gjykatësit. Parimisht ShBA-ja nuk i futi këto ilaçet dhe ushqimet në listën e sanksioneve, por Irani e ka të pamundur t'i sigurojë ato për shkak të kushteve të ashpra për transfertat financiare me këtë vend. Prandaj Gjykata Ndërkombëtare dha të mërkurën vendimin, megjithëse ky është vendim paraprak, sepse mbyllja e çështjes mund të kërkojë vite. Irani e përshëndeti të mërkurën vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare. "Vendimi ishte një njohje e qëndrimit tonë legjitim", deklaroi

Ministria e Jashtme në Teheran. Vendimi sipas së drejtës ndërkombëtare është detyrues. Por që më parë ShBA kishte deklaruar, se ato nuk e kanë këtë gjykatë përgjegjëse për çështjen. Gjykata Ndërkombëtare është Tribunali i Kombeve të Bashkuara për rregullimin e grindjeve ndërkombëtare. Vendimet e tij vërtet janë detyruese, por kjo instancë nuk ka mjete për realizimin e vendimeve. Si ShBA-ja ashtu edhe Irani i kanë injoruar në mënyrë të përsëritur vendimet e kësaj gjykate. ShBA-ja hoqi dorë në mënyrë



të njëanshme nga marrëveshja me Iranin dhe vendosi në maj sërish sanksione kundër Republikës Islamike. Këto mund të shkelin një marrëveshje të miqësisë të vitit 1955 mes dy vendeve, deklaroi gjykata.

Kjo duhet të sqarohet ligjërisht-Deri atëherë, ShBA-ja duhet të heqë dorë nga sanksionet që janë më kërcënuese. Se kur do të fillojë seanca kryesore për këtë çështje, nuk është përcaktuar ende.

## Britania akuzon Rusinë për sulme kibernetike



Londër, 4 tetor - Britania akuzoi inteligjencën ushtarake ruse për një sulm kibernetike, me qëllim dëmtimin e institucioneve të rëndësishme perëndimore. Një raport për sigurinë kombëtare të Britanisë konstatoi se Agjencia e Inteligjencës Ushtarake të Rusisë (GRU) është "agresore shkatërruese

kibernetike", që përdor një rrjet hakerësh për të përhapur mosmarrëveshje dhe konfuzion në gjithë botën. "GRU qëndron me siguri pas sulmit me softuerin 'BadRabbit', vitin e kaluar, ndaj një aeroporti ndërkombëtar të Ukrainës, si dhe pas piraterimit të Agjencisë Botërore Anti-Doping në Zvicër", thuhet në

raport. Raporti i Qeverisë britanike po ashtu konstatoi se GRU qëndron pas piraterimit të e-maileve të Komitetit Kombëtar të Partisë Demokratike në ShBA, që dëmtuan kandidaten për presidente të ShBA-së, Hillary Clinton. Kjo e fundit u mund nga republikani Donald Trump, në zgjedhjet e vitit 2016.

## Putini në Indi, synon nënshkrim të marrëveshjes miliardëshe

MOSKË, 4 TETOR - Presidenti rus, Vladimir Putin, ka nisur të mërkurën vizitën e tij dyditore në Indi, me qëllim të thellimit të lidhjeve të Rusisë me shtetin, ekonominë e të cilit është duke u rritur me shpejtësi të madhe. Putini dhe kryeministri indian, Narendra Modi pritet të rishqyrtojnë bashkëpunimin në çështjet e

mbrojtjes dhe të diskutojnë lidhjet në aspektin rajonal dhe atë global në një samit dypalësh në Nju Delhi sot (e premte), ka njoftuar Ministria e Jashtme e Indisë. Ndhimësi i Putinit, Yury Ushakov, ka thënë se bisedimet e presidentit rus me Modin do të fokusohen "në partneritetin strategjik ruso-indian". Gjatë kësaj kohe pritet të nën-

shkruhen më shumë se 20 marrëveshje në mbrojtje, çështje hapësirë dhe ekonomi, ka thënë Ushakov, duke insistuar se "çështje kyçe" e udhëtimit mbetet nënshkrimi i një pakti 5 miliardë dollarë për të furnizuar Indinë me sisteme raketore të mbrojtjes S-400. Moska ka negociuar me Indinë për t'i shitur raketa me reze të gjatë

veprimi për muaj të tërë andaj Pentagoni ka paralajmëruar Nju Delhin se do të mund të preket nga sanksionet amerikane, nëse blen këto sisteme të sofistikuar. Uashingtoni dhe Nju Delhi kanë premtuar se do të bashkëpunojnë më ngushtë në çështje të mbrojtjes, mirëpo Rusia vazhdon të jetë furnizuesi kryesor i armëve për



Indinë, e përcjell nga Shtetet e Bashkuara.

## Johnny Depp thyen heshtjen: Nuk jam njeri i dhunshëm



Aktori Johnny Depp ka mohuar të jetë i dhunshëm. Ai ka treguar se historia me ish-bashkëshorten e tij, Amber Heard, e ka kthyer nga "Hirushe në Kuazimodo". Në intervistën e tij të parë mbi martesën e dështuar, aktori


i famshëm ka pohuar për revistën "GQ" se tre vjetët e fundit kanë qenë për të si një "situatë perverse" që iu imponua. "E ndieja që njerëzit më shikonin ndryshe pasi ajo tha se e kisha dhunuar, gjë të cilën nuk e kam bërë", ka deklaruar Depp.

## Kimit i vodhën miliona dollarë bizhuteri, paditet truproja e Kardashianit



Kompania e sigurimeve që ka paguar Kim Kardashiani, pasi i vodhën në Paris bizhuteri me vlerë miliona dollarë dy vjet më parë, ka paditur ish-truprojën e saj. Grupi Ndërkombëtar Amerikan, i njohur edhe si AIG, ngriti një padi të mërkurën në Delaware kundër

Pascal Duvier dhe kompanisë së tij "Protect Security", duke kërkuar 6.1 milion dollarë, sipas dokumenteve të gjykatës. Një burim i ka thënë "CNN"-së se gjatë asaj kohe truprojat ishin me motrat e Kimit në një klub nate, por nuk specifikonin nëse aty ishte Duvier.



## Enrique Iglesias, puthje pasionante me fansën

Enrique Iglesias i ka habitur të gjithë teksa i ka dhuruar një puthje pasionante një fansë. Këngëtari spanjoll po performonte në Kiev, kur një grua u ngjit në

skenë dhe Iglesias e puthi në buzë. 43-vjeçari është në një lidhje me Anna Kournikova që prej vitit 2001. Nuk dihet nëse kjo puthje ka krijuar probleme mes çiftit.

## Justin dhe Hailey së bashku në kishë



Justin Bieber dhe Hailey Baldwin kanë bërë disa lutje në kishë. Çifti që raportohet se janë martuar, arriti në kishë të mërkurën mbrëma në Beverly Hills. Justini u pa i veshur me një xhakë të blu

UCLA dhe një kapelë ngjyrë kafe pasi u largua nga shërbimi. Dyshja raportohet se janë zyrtarisht të martuar, por Hailey më parë kishte shkruar në "Twitter" se ata nuk janë martuar ende.

**E rrallë**

## Preku gruan me veshje islame, shitësi dënohet me burg

Një shitës pakistanez është dënuar me tre muaj burgim pasi preku një grua arabe që kishte veshje islame. Incidenti ka ndodhur në zonën Naif. Menjëherë pas ngjarjes, grua e denoncoi burrin në polici. Avokati i të pandehurit këmbënguli se shitësi nuk kishte



qëllim ta prekte gruan, por nuk u mor parasysh nga gjykatësit.

**FOTO E DITES**



Zonja e Parë Melania Trump shihet në një ceremoni mirëseardhëse për në Gana.

**E jashtëzakonshme**

## Uiski i vitit 1926 shitet në ankand për një shumë marramendëse

Një shishe uiski e vitit 1926 është shitur në ankand për 1.1 milion dollarë. 'Macallan' është shishja më të shtrenjtë e uiskit që është shitur ndonjëherë në ankand. Uiski u shit në ankandin



Bonhams në Edinburg dhe u ble nga një koleksionist privat në Azi me anë të telefonit. Pija alkooolike është distiluar në vitin 1926 dh u fut në shishe më 1986.

**BARSOLETA E DITËS**



**E dashura:** Shpirt, më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur. **Të lutem,** më bëj një kompliment. **I dashuri:** Zemër, ke shikim shumë të mirë!



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

### “HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation” 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

### “THE DARKEST MINDS”

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson

Në ora 20:00 dhe 22:00

### “THE PREDATOR” 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Jeni të shpërçendruar sot sepse po i mbyllni gjërat e rëndësishme në sekondë të fundit. Kjo ju ka vënë nën presion.



**DEMI**

Edhe pse duket se dita nuk do të mbyllet mirë, vetëm me një komunikim të shpejtë me partnerin do t'i jepni zgjidhje gjithçkaje.



**BINJAKËT**

Sot do t'ju realizohen të gjitha ëndrrat për karrierën dhe financat e mira. Fati po ju ndihmon më shumë sesa që duhet.



**GAFORRJA**

Do të keni disa debate të nxehta me partnerin për këndvështrimet e ndryshme me të cilat i shikoni gjërat.



**LUANI**

Doni të ndryshoni disa gjëra që i përkasin rutinës suaj të përditshme. Edhe ju vetë do ta keni pak vështirë në fillim të ambientoheni.



**IRGJËRESHA**

Sot mbrëmja është shumë e këndshme si për një takim dashurie, po ashtu edhe për një mbledhje mes miqsh duke shijuar biseda interesante.



**PESHORJA**

Të gjitha vendimet tuaja sot do të kenë referencë një person të caktuar. Jeni në rrugën e duhur dhe të vetëdijshëm për çfarë po bëni.



**AKREPI**

Sot dita ka uljet dhe ngritjet e veta dhe ju jeni në mes tyre duke përballuar çdo situatë mjaft mirë.



**SHIGJETARI**

Dita e sotme do të jetë e mbushur me takime dhe marrëveshje që nuk është se do të japin ndonjë zgjidhje përfundimtare për problemet tuaja.



**BRICJAPI**

Sot do t'i befasoni të gjithë me reagimin tuaj të cilin nuk e prishte askush. Duke qenë zakonisht të mbyllur e të qetë, shpërthimi i sotëm do të jetë çlirim.



**UJORI**

Nuk jeni të qetë sepse shumë çështje varen nga ju sot. Doni të bëni një zgjidhje sa më korrekte, por kjo gjithë influencën në humorin tuaj.



**PESHQIT**

Fillimi i ditës ju gjen të mbingarkuar me punë. Do të donit disa ditë pushim, por kjo do të mbetet thjesht ëndërr në sirtar.

**EURO GLASS**  
SAINT-DOMAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adri: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

VFL BOCHUM - ARMINIA BIELEFELD

1

AJACCIO GFCO - ORLEANS

1

TONDELA - NACIONAL

1

# Zollneri largohet nga Prishtina, vjen Mulaomeroviqi

Ndryshime interesante ka bërë skuadra e basketbollit, Prishtina, e cila fillimisht ndërpreu bashkëpunimin me trajnerin Matthias Zollner, kurse menjëherë të enjten reagoi kryesia e klubit, duke e angazhuar Damir Mulaomeroviqt pasardhës të trajnerit gjerman

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 TETOR - KB Z Mobile Prishtina të enjten ka bërë ndryshime në krye të shtabit teknik. Klubi kryeqytetas i basketbollit dhe trajneri Matthias Zollner kanë arritur marrëveshje për ndërprerjen e bashkëpunimit, kurse gazeta ka mësuar se ka pasur mosmarrëveshje dhe krijim të klaneve te lojtarët. Skuadra më e fortë e Kosovës në basketboll u eliminua nga gara e Ligës së Kampioneve, edhe përkundër faktit se e mposhti Donar Groningenin me rezultat bindës (84-64), në ndeshjen e parë të zhvilluar në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, por në ndeshjen e dytë Prishtina pësoi humbje me rezultat të thellë 80:55. Në këtë ndeshje pati edhe përleshje në mes të basketbollistëve "bardhekaltër", çka rezultoi edhe me largimin e trajnerit gjerman nga kryeqyteti i Kosovës. "Pas analizave të mirëfillta të bëra nga kryesia e klubit në bashkëpunim me Zollnerit, janë pajtuar që në mënyrë të dyanshme ta përfundojnë marrëveshjen dhe nga sot gjermani të mos jetë në krye me të ekipit tonë", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

Trajneri gjerman me skuadrën kryeqytetase arriti ta fitojë Superkupën e Kosovës në basketboll, kurse KB Prishtina e ka falënderuar Zollnerin për punën profesionale dhe angazhimin e madh që ka dhënë për klubin "bardhekaltër". Drejtuesit e skuadrës së Prishtinës nuk kanë humbur kohë dhe menjëherë e kanë gjetur pasardhësin e gjermanit. Bëhet



fjalë për ish-basketbollistin e mirënjohur Damir Mulaomeroviq, i cili javë me parë e mori edhe drejtimin e Përfaqësueses së Kosovës. "Si lojtar ka qenë pjesë e ekipeve më të famshme si Cibona, Efes, Panathinaikos, PAOK, Olympiacos dhe Real Madrid, ku ka fituar tituj prestigjiozë individualë dhe ekiporë, si: kampion e fitues i Kupës së Kroacisë, fitues i Kupës së Turqisë, koshashënuesi më i mirë dhe tri herë All-Star në Superligën greke, fitues i Euro Ligës me Real Madridin e shumë të tjerë. Ai gjithashtu ka qenë reprezentues i

rregullt i Kroacisë", thuhet në njoftimin e Prishtinës. "Pas karrierës së suksesshme si lojtar, atij nuk i munguan sukseset as në zejen e trajnerit. Mulaomeroviqi si trajner filloi me ekipin e vendlindjes së tij, Sloboda Tuzla, të cilën e udhëhoqi për dy vjet. Pas ekipit boshnjak ai u emërua timonier i skuadrës së famshme evropiane Cibona nga Zagrebi, kurse së fundmi udhëhoqi përfaqësuesen e Bosnja dhe Hercegovinës. Muaj më parë ai mori drejtimin e Kosovës", thuhet në njoftimin e skuadrës nga kryeqyteti.

SHKURT

## Prekazi publikon listën e futbollistëve për ndeshjen kundër Izraelit

Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës U21, Rafet Prekazi, ka publikuar listën e futbollistëve të cilët do t'i ketë në dispozicion për ndeshjen e fundit në kuadër të kualifikimeve për Evropianin 2019 kundër Izraelit më 16 tetor. Grumbullimi i futbollistëve do të bëhet më 9 tetor në hotel "International Prishtina", kurse stërvitja e parë do të mbahet në fushën "Top Football" në Mazgit, në orën 15:00. Lista e futbollistëve: Florijan Smakiqi, Ardit Nika, Kreshnik Hajrizi, Ismajl Beka, Ardijan Ismajli, Dren Feka, Lirim Mema, Besfort Kolgeci, Fuad Rahimi, Donat Hasanaj, Medjon Hoxha, Dardan Karimani, Kushtrim Shabani, Dilan Qela, Arbënor Muja, Muharrem Jashari, Edmond Ramadani, Rron Broja, Arbër Hoxha, Florent Hasani, Meriton Korenica, Mirlind Daku.

## Challandesi lë jashtë Celinën

Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, pritet ta lë jashtë listës lojtarin Bersant Celina, i cili ka shfaqur pakënaqësi me minutat e ofruara nga trajneri zviceran. Celina është një lojtar i rritur në akademinë e Manchester Cityt, kurse aktualisht mbron ngjyrat e skuadrës së Swansea Cityt. Kosova do të luajë ndaj Maltës më 11 tetor në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse tri ditë më vonë i shkon Ishujve Faroe.

## Cana, Garcias: Gustavo nuk është mbrojtës

Lorik Cana duket se nuk heq dot dorë nga Marseille. Të gjithë e mbajnë mend shumë mirë ish-lojtarin e tyre i cili ka pasur aftësi të veçanta lidhshme kur ka luajtur së fundmi për francezët. Ndërsa së fundmi, i pyetur në lidhje me situatën në të cilën gjendet skuadra franceze, Cana u shpreh me tone kritike për trajnerin Rudi Garcia. E gjitha lidhej me pozicionin e lojtarit Luis Gustavo. Braziliiani së fundmi është aktivizuar në mbrojtje, një pozicion i cili nuk është natyral, për të pasi ai luan në mesfushë dhe këtë ka dashur edhe Cana t'ia bëjë të qartë trajnerit Garcia. "Ai nuk është një mbrojtës. Nuk mendoj se Gustavo është lojtari i duhur për t'u përshtatur në qendër të mbrojtjes. Ai mund të ndihmojë dhe po e bën. Më vjen keq, por nuk është mbrojtës. Në mesfushë, ti mund t'i lejojsh vetes të humbësh një apo dy herë topin. Diçka normale, por mbrapa është e ndaluar", ka thënë Cana.

## Southgate vazhdon kontratën me Anglinë

Trajneri Gareth Southgate ka nënshkruar një kontratë të re me Anglinë deri në Botërorin e 2022-it. Ai e udhëhoqi Anglinë deri në gjysmëfinalet e Kupës së Botës të zhvilluar në Rusi, gjë që nuk ndodhet prej 28 vjetësh. "Ndihem krenar që do ta kem mundësinë ta drejtoj kombëtaren në dy kompeticionet e ardhshme të mëdha", ka thënë Southgate, i cili do të fitojë tre milionë sterlina nga marrëveshja e re, 1.2 më shumë në krahasim me kontratën e mëparshme.

## Flamurtari dhe Gjilani ndajnë pikët

PRISHTINË, 4 MARS - Skuadra e Flamurtarit dhe ajo e Gjilanit kanë luajtur të enjten baras (1-1), në ndeshjen e fundit të javës së tetë në IPKO Superligë. Kjo

ndeshje u zhvillua në stadiumin "Xhemal Ibishi" në kryeqytet dhe zgjoi një interesim të madh. Kuqezinjtë e Flamurtarit shënuan në fillim të ndeshjes, nëpërmjet

sulmuesit kryesor Alban Shillova, kurse mysafirët nuk u dorëzuan për asnjë moment dhe e barazuan rezultatin 1-1, me golin e shënuar nga Trevin Ceasar në

minutën e 40. Pas kësaj xhiroje, Flamurtari zë vendin e tretë me 15 pikë të grumbulluara, kurse Gjilani është në pozitën e pestë me 14 pikë.



## "Epoka e re" sonte përballet me "Zërin"

PRISHTINË, 4 MARS - Sot (e premte) zhvillohen ndeshjet e xhiros së katërt në Media Ligë. Ekipi i gazetës "Epoka e re" do të luajë në orën 19:35 ndaj ekipit të "Zërit". Pavarësisht prej rezultat-

eve jo të mira të arritura nga ekipi i "Zërit" në xhirot e para, kjo ndeshje pritet të jetë shumë e fortë, kurse synimi i "Epokës së re" edhe në këtë ndeshje është fitorja.

Skuadra e parë në Ligën e Medieve, "Lajmi.net", do të ketë një ndeshje të vështirë para vetes, pasi do të luajë ndaj ekipit të "KosovaPress"-it, i cili, prej tri ndeshjeve të luajtura, ka

regjistruar dy fitore dhe një humbje. Një tjetër ndeshje interesante pritet të zhvillohet edhe në mes të ekipit të "Infokusit" dhe ekipit të "Media Works"-it.



## Gjilani po bëhet me stadium të standardeve të FIFA-s dhe UEFA-s

GJILAN, 4 TETOR - Në kuadër të vizitave në terren të projekteve infrastrukturore, përfaqësuesit e Komunës së Gjilanit kanë parë nga afër punimet në stadiumin e qytetit. Nën kryetari i komunës, Arbër Ismajli, i cili shoqërohej nga deputeti Imet Rrahmani dhe bashkëpunëtorët, ka marrë zotimin e projekt-menaxherit se rindërtimi i stadiumit do të përfundojë sipas planit dinamik. "Duke marrë parasysh që Gjilani njihet si qytet i sportit, ky projekt është tepër i rëndësishëm. Është investimi më i madh kapital në infrastrukturën sportive falë angazhimit dhe autoritetit të kryetarit Haziri për ta sjellë këtë projekt në Gjilan. Besoj shumë se operatori në fjalë do ta implementojë këtë projekt sipas kontratës. Lajm i mirë është që kemi



një dinamikë të madhe në punë", ka thënë Ismajli.

Rindërtimi i stadiumit të qytetit përfshinë tribunat e reja në dy anët veri-jug, ndërsa ato të vjetrat

do të rikonstruohen. Ky është stadium i kategorisë së katërt sipas standardeve të FIFA-s dhe UEFA-s dhe i plotëson kushtet për ndeshje ndërkombëtare.

## Drama në jetën e Naser Alijit, nga sëmundja e babait te falsifikimet

CYRIH, 4 MARS - Naser Aliji është duke përjetuar një dramë në jetën e tij. Mbrojtësi i majtë nga Kumanova, i cili ka veshur fanellën e kombëtares shqiptare, është aktualisht pa klub. Megjithatë, ky duket se është problemi më i vogël që ai ka, sepse ka arsye më madhore që e kanë detyruar të qëndrojë larg sportit të tij të preferuar. Në një intervistë për "Blick.ch", Aliji ka treguar gjithë kalvarin e vuajtjeve, duke filluar me babanë e tij i cili ka ndërruar jetë. "Po stërvitem te Badeni për të qenë në formë. Isha i zhgënjyer këtë verë pasi nuk kisha klub. Megjithatë, kuptova shumë, kuptova se duhet të qëndroja më shumë me babanë tim i cili vuante nga kanceri", ka thënë Aliji. "Kam pasur mendime të tjera se sa për një klub ku mund të luaja. Doja të rrija në Itali, por problemet vazh-



uan. Menaxherët falsifikuan firmën time për të bërë bisedime me klube të tjera. Në Itali e humbën besimin tek unë, megjithëse këtë çështje do

ta ndjek deri në fund. Dua të qëndroj pranë familjes dhe një klub jashtë vendit nuk është në prioritetet e mia", ka përfunduar Aliji.

### SHKURT

#### Henry shihet si pasardhës i Bruce te Aston Villa

Ish-sulmuesi i Arsenalit, Thierry Henry, përmendet si një nga kandidatët potencialë për t'u ulur në stolin e Aston Villas, e cila sapo ka shkarkuar trajnerin Steve Bruce për shkak të rezultateve të dobëta që ka regjistruar në Championship. Interesant është fakti se edhe gjatë verës Henry u përmend shpesh si një nga kandidatët për ta drejtuar skuadrën nga Birminghami, por drejtuesit vendosën t'i besonin sërish Steve Bruce. Golashënuesi më i mirë në historinë e kombëtares franceze ishte pranë stolit të Bordeauxit pak javë më parë, por mes palëve nuk u arrit një marrëveshje.

#### Spalletti: Icardi, sulmues i përsosur

Luciano Spalletti vlerësoi Mauro Icardin si "sulmues i përsosur", pasi kapiteni i Interit dyfishoi rezultatin e ndeshjes së dytë në grup, për llogari të Ligës së Kampionëve (fitorja 2-1) ndaj PSV-së. "Icardi është sulmues i përsosur. Nëse flasim për finalizimin e aksioneve, ai është i plotë, një 'kafshë e vërtetë' para portave kundërshtare. Ndonjëherë ai duhet të kthehet për të ndihmuar në mesfushë më shumë, në vend se të shkojë përpara. Icardi e bëri këtë disa herë në ndeshjen ndaj PSV-së. Ishte shumë i rëndësishëm për ne. Mendoj se mund të kishim shënuar më shumë gola, duke sulmuar me vendosmëri, kur kemi pasur hapësira", ka thënë Spalletti.

#### Hamiltoni: Nuk e kuptoj largimin e Raikkonenit

Ferrari ka vendosur ta ndërpresë marrëdhënien me pilotin finlandez, Kimi Raikkonen dhe në vend të tij do t'i besojë pilotit nga principata e Monacos, Charles Leclerc, duke filluar që nga sezoni i ardhshëm i Formulës 1. Raikkoneni është edhe fitues i një titulli kampion bote me "kokëkuqen" në vitin 2007, ndaj edhe vendimi për largimin e tij është pritur me kritika nga shumë tifozë të Ferrarit. Por kritikën për këtë vendim kanë ardhur edhe nga rivali i skuadrës italiane, piloti i Mercedesit, Lewis Hamilton, i cili tha se Ferrari po humbte shumë me këtë. "Nuk e kam kuptuar asnjëherë vendimin e Ferrarit, për ta larguar Kimi Raikkonenin dhe për t'i besuar Leclerc. Kimi është një pilot i jashtëzakonshëm dhe një nga të preferuarit e mi, ndaj largimi i tij është një humbje e madhe edhe për një skuadër si Ferrari", ka deklaruar Hamiltoni. Kampioni në fuqi i botës theksoi se fakti që Raikkoneni e di se do të largohet në fund të sezonit, nuk do të ndikojë aspak në performancën e finlandezit në këto pesë gara të fundit të sezonit.

#### Simeone: Griezmann, lojtari më i mirë në botë

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, e ka përshkruar yllin e skuadrës së tij, Antoine Griezmann, si lojtarin më të mirë në botë, pas ndikimit që kishte francezi në ndeshjen e Ligës së Kampionëve. Në xhiron e dytë, të vlefshme për grupin A të Ligës së Kampionëve, Atletico Madridi e mposhti Club Brugge me rezultat 3-1, kurse francezi shënoi dy gola. "Unë kam thënë edhe sezonin e kaluar dhe do ta them përsëri, për mua Griezmanni është lojtari më i mirë në botë. Ai e ka fituar titullin e Evropës Ligë, Kupën e Botës, Superkupën e Evropës dhe përfundoi në vendin e dytë në një ligë ku luajnë Barcelona dhe Real Madridi. Ai është në një vend ku dëshiron të jetë. Ai vendosi të qëndrojë në Atletico dhe këto janë pasojat. Ai është duke e shijuar një moment të rëndësishëm në karrierën e tij", ka thënë Simeone.

#### Miliki plaçkitet pas ndeshjes me Liverpoolin

Nga gëzimi i madh për fitoren e marrë në fund të ndeshjes ndaj Liverpoolit në frikën e madhe të kaluar pas grabitjes së pësuar. Kështu mund të përmblihet mbrëmja e sulmuesit të Napolit, Arkadiusz Milik, i cili është grabitur me pistoletë në kokë. Në një rrugë afër banesës së tij në Napoli sulmuesit Milik i janë afuar dy persona që udhëtonin me një "Scuter" dhe i kanë marrë një orë "Rolex" me vlerë 7 000 euro. Kjo nuk është hera e parë që një lojtar i Napolit përjeton një ngjarje të tillë, ndërsa policia ka nisur hetimet.

#### PSG-ja në garë për Pogban

Tabloidi britanik "The Sun" raporton se duke parë raportet gjithnjë e më të këqija me trajnerin Jose Mourinho, mesfushori francez Paul Pogba ka vendosur të largohet nga Manchester Unitedi që në muajin janar, pikërisht në drejtim të kampionëve të Francës, Paris Saint Germain. Por gjithçka do të varet nga e ardhmja e Mourinhos në stolin e "djaljeve të kuq". Nëse portugezi do të shkarkohet, atëherë Pogba mund të vendosë të qëndrojë deri në fund të sezonit, për të rifilluar çdo tentim gjatë muajve të verës.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government  
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of  
Labour and Social Welfare  
INSPEKTORATI I PUNËS

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L – 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karriere të Nëpunësve Civilë, duke marr parasysh Rregulloren nr.15/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin e Punës, Inspektorati i Punës shpallë :

### Konkurs

Titulli i vendit të punës: Inspektor i Punës – 3 pozita

Referenca :

Koeficienti : 8 (tetë),

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Akt Emërimi: Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

I përgjigjet : Udhëheqësit të Divizionit të Koordinimeve

Vendi : Kosovë

Qëllimi i vendit të punës :

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve që bien në mandat të Inspektorit të Punës.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

**Detyra,1:** Inspektori i punës kontrollon në mënyrë unike të gjitha vendet e punës që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës si dhe sigurinë dhe shëndetin në punë.

**Detyra,2:** Jep vërejtje me shkrim për parregullsi ose shqipton gjykon me vendim në shkallën e parë;

**Detyra,3:** Sigurojnë informacione dhe këshilla për zbatimin e dispozitave të aplikueshme, me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës si dhe siguria dhe shëndeti në punë.

**Detyra,4** Bëjnë kontrollimin e të gjitha librave të punëdhënësve që duhet t'i mbajnë ata në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Detyra,5:** Bëjnë inspektimin e vendit të punës ku është shkaktuar lëndimi i rëndë ose vdekja e një apo më shumë punëtorëve ose ka ndodhë ndryshim në procesin e punës i cili ka rrezikuar jetën e punëtorëve.

**Detyra,6:** Inspekton vendet e punës dhe vepron në ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit,

**Detyra,7:** Urdhëron ndalimin e prodhimit ose procesin e punës aty ku ka fakte të pamohueshme dhe të verifikurara se kushtet në vendin e punës paraqesin rrezik të drejtpërdrejt për jetën, shëndetin apo sigurinë e palëve në vendin e punës

**Detyra,8:** Urdhëron ndalimin e punës në rastin kur punëdhënësi nuk posedon lejen e punës

**Detyra,9:** Ruajtjen në konfidencë të plotë burimin e ndonjë ankese që atyre u është paraqitur në lidhje me ndonjë veprim që ka të bëjë me shkëlqen e ligjit

**Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathësitë tjera :**

Diplomë universitare të fakultetit juridik, shkencat teknike. Përvojë pune 3 vjeçare. Të njoh punën me kompjuter. Të njoh shkëlqyeshëm gjuhën shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar, kërkesat e dëshirueshme të njoh gjuhën angleze.

**Shënim:** Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Inspektorati i Punës ofron mundësi të barabarta dhe pa diskriminim. Rekrutimi dhe Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe legjislacionin tjetër të fuqi.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve : IP/ Zyra e arkivës, Rr.“Qamil Hoxha“

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Arkivit të IP-së tel.038/213-369 ose 200 26 138 prej orës 08:00 – 16:00

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë** nga dita e publikimit, duke filluar nga data **05.10.2018** deri më datën **19.10.2018 deri në ora 16:00** që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government  
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite -  
Ministry of Labour and Social Welfare  
INSPEKTORAT RADA

Na osnovu Zakona br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova član 18,i Uredbe br. 02/2010 o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova i Uredbe br.21/20125 o Unapređenja u Karijeri Civilnih Službenika,imajuci u obziru Uredbe br.15/2015 za Unutrasnje Organizovanje i Sistemizaciju Radnih Mesta u Inspektorat Rada ,Inspektorad Rada objavljuje :

### KONKURS

Naziv rada: Inspektor Rada - 3 radna mesta

Referencija :

Koeficientat: 8 (osam)

Funksionalna kategorija : Profesionalni nivo

Akt Imenovanja : Prema Zakonu o Civilnoj Službi Republike Kosova

Izveštava : Rukovodiocu Divizije Koordiniranja

Mesto: Kosovo

**Namena radnog mesta:**

Nadzor sprovođenja zakona koji spadaju u nadležnost Inspektorata Rada .

**Zadaci i odgovornosti :**

**Zadatak 1:**Inspektor rada kontrolise na jedinstven način sva radna mesta, koja se odnose na radni odnos kao i na bezbednost i zdravlje na radu;

**Zadatak 2:**Daje pismenu opomenu za neurednosti ili izriče kaznu odlukom prvog stepena;

**Zadatak 3:**Obezbede informacije i savete za sprovođenje primenjivih odredaba ,sa kojima se uređuje radni odnos;

**Zadatak 4:**Vrše kontrolu svih knjiga poslodavaca za koje su dužni da poseduju na osnovu zakonodavstvo na snazi;

**Zadatak 5:** Vrše inspekciju radnog mesta na kojem je prouzrokovana teška povreda ili smrt jednog ili više radnika.

**Zadatak 6:**Vrsi Inspekciju radno mesto i deluje u sprečavanje svih oblika diskriminacije

**Zadatak 7:**Naređuje obustavu proizvodnju ili proces rada tamo gde ima nepobitnih činjenica i da je provereno da uslovi na radanom mestu predstavljaju direktno rizik po zivot ,zdravlje ili sigurnost radnika.

**Zadatak 8 :**Naređuje prekid rada u slučaju kada poslodavac ne poseduje dozvolu za rad.

**Zadatak 9:** Drzjanje potpune poverljivosti izvora neke žalbe koja je upucena u vezi nekog prestupa koja je u suprotnosti sa zakonom.

**Kvalifikacije, radno iskustvo, veštine i druge veštine:**

Universitetska Diploma iz oblasti pravni fakultet ,tehničke nauke .Radno iskustvo 3(tri) godine.Poznavati rad na kompjuteru.Poznavati odlicno albanski i srpski jezik usmeno I pismeno,povoljnost je poznavati engleski jezik.

**Napomena :** Procedura konkurisanja je otvorena za sve zainteresovane koji ispunjavaju kriterijume konkursa.Inspektorijata Rada pruža jednake mogućnosti bez diskriminacije. Zapošljavanje i Selekcija će se vršiti u skladu sa Zakonom br. 03 / Z - 149 o Civilnoj Službi Republike Kosova , Uredbe br . 02/2010 za Procedure Zapošljavanja u Državnoj Službi i Uredbe br. 21/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi kao i zakonodavstva na snazi.

**Podizanje i dostava aplikacija:**IR/Kancelarija Arhive UL“Qamil Hoxha“

Za detaljnije informacije mozete kontaktirati Kancelariju Arhive IR, fix /tel 038/213-369 ili 200 26 138 od 08:00 -16:00 svakog radnog dana.

**Konkurs ostaje otvoren 15 dana** od dana objavljivanja. Rok za prijavu je od **05.10.2018** do **19.10.2018 do kraja radnog vremena 16:00** koje oznacava poslednji dan zavrsetak konkursa .

Aplikacije poslate poštom koje nose pečat od poslednjeg dana roka za aplikaciju, će se smatrati validnimi i uzeti u obziru, dok aplikacije koja stižu nakon predvidenog zakonskog roka neće biti razmatrane.

